



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 1 Tetor 2011  
ISSN 2225-2959



**& Kolaterali bankar  
ndikimi në ekonomi**



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Nëpërmjet bashkëpunimit efektiv,  
AAB kombinon energjitë dhe perspektivat e anëtarëve të saj  
për të sjellë ndryshime pozitive në sistem





## Mesazh nga KRYETARI



*Kolegët e mi më të hershëm mund ta rikujtojnë se para krijimit të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), ne ishim të organizuar në Klubin e Bankierëve Shqiptarë (ABC). Gjatë shndërrimit të ABC-së në AAB patëm diskutuar gjatë mbi faktin nëse Shoqata duhet të jetë e bankave apo e bankierëve. Edhe pse në fund vendosëm për një shoqatë të bankave, sipas praktikës ndërkombëtare, fryma e mbledhjes për interesa të përbashkëta të të gjithë bankierëve ka qenë brenda nesh që nga dita e parë. Ky publikim nuk është gjë tjetër veçse një nga produktet e kësaj fryme. Ne i përkasim grupeve të ndryshme bankare si dhe kombësive të ndryshme, por në fund të fundit ne jemi të gjithë bankierë shqiptarë dhe “BANKIERI” do ta përforcojë më tej këtë emërues të përbashkët.*

*Për më tepër, “BANKIERI” do të jetë zëri i industrisë bankare në drejtim të autoriteteve, partnerëve të biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë. Sigurisht që ai do të krijojë vlerë të shtuar në komunikimin tonë me të gjithë grupet e interesit.*

*Së fundi, kjo revistë do të ketë dhe një rol edukues lidhur me trajtimin e çështjeve të përditshme bankare dhe financiare, me qëllim që jo vetëm bankierët, por edhe publiku në përgjithësi të mund të përmirësojnë njohuritë e tyre financiare.*

*I uroj personalisht BANKIERI-t sukses të madh dhe falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar për të.*

Seyhan PENCAPLIGIL

Kryetar i AAB-së

  
**Bankieri**

**Maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja**

**ALPHA SMART**

ALPHA BANK

**Mjaft me lojëra**

**Blijeni dhe shijojeni tani shtëpinë tuaj të vërtetë**

**Kredi për Shtëpi nga BKT**  
Mirësitë në kohë rikund dhe interesat më të ulta në Lekë

**Ne shprehim Ar24 karatë Monedha të çmuara.**

**CREDINS bank**

**CBA CREDIT BANK OF ALBANIA**

**OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURJEUZE NË TREGUN BANKARË**

**CBA CREDIT BANK**

**Emporiki Bank**  
CREDIT AGRICOLE GROUP

Anëtare e Grupit në të Mësh Banker në Francë

**Depozita Perfekte**

Interesi 1 vit - 4% EURO.  
Shton/hiqet në çdo kohë, pa humbur interesin.  
E vlefshme për çdo lloj shume.

**Fibank**  
First Investment Bank

**"Qëndroni me Ne për të mirë në Treg"**

**Ofertën**

**Intesa së bashku me NE!**

**BESOJANI DEPOZITAT TUAJA INTESA SANPAOLO BANK**

**INTESA SANPAOLO BANK**  
Përfundim i shprehur me ju

**DEPOZITË ME AFAT**

**Kartë shëndeti**

**Depozitoni dhe përfitoni falas kartën e shëndetit Hygeia!**

**NBG Bank**

**ProCredit Bank**

**KREDIA "EFICIENCIA E ENERGJISË"**

**eko**

**Kredi për Shtëpi**

**Mos prisni më! Tani është koha ta bëni tuajën.**

**Raffaelsen BANK**

**deri në 4,55%**

**Depozita në EURO**

**Përvoja Franceze për më të mirën e Shqipërisë**

**SOCIETE GENERALE ALBANIA**

**Së bashku për një të nesërme më të mirë!**

**TIRANA BANK**

**UNIONBANK**  
banka që duan

**Kredia Home Equity**

**Makinë e Re? paguaj €243 në muaj**

**www.unionbank.al**

**UBA**  
Banka e Rrafshit të Shqipërisë CREDIT BANK OF ALBANIA

**Kredi • Depozita • Biznes • Transferta**

**KEMI FTUAR QËTESINË ME UBA**

**VENETO BANK**  
BANKA ITALIANE

# Përmbajtja



Kryeartikulli  
f.7

A është koha e “DASHURISË”  
së bankave me biznesin?!

Mesazh nga Kryetari

f.3

## DOSSIER

Kolaterali dhe ndikimi në ekonomi

f.9

## DEBAT

Financimi me obligacione, një alternativë e re për financimin e shoqërive tregtare nga Elvin Meka

f.13

## EDUKIMI Financiar

Strategji Kombëtare për edukimin financiar nga Klodi Tomorri

f.16

Nga “phishing” tek “vishing” nga Roland Tashi

f.17

## SISTEMI

Sigurimi i depozitave, midis stabilitetit financiar dhe mbrojtjes së kursimtarëve

Intervistë me Skënder Emiri & Plator Ulqinaku

f.21

## TREGU

Efiçenca e Energjisë

Dërgesat nga emigrantët, depozitat dhe bankat nga Lindita Varesi

f.26

f.28

## FLASIN EKSPERTET

Sistemi i pagesave në Shqipëri, një histori suksesi nga Najada Xhaxha

f.31

## ANALIZË

Bankat shqiptare, kujdesi për të mbajtur të pacënuar sistemin nga Klodi Tomorri

f.35

Fqinjia jugor dhe bankat e tij në Shqipëri nga Kasem Seferi

f.38

## SOCIALE

Përgjegjshmëria sociale, pjesë e administrimit dhe kulturës së bankave

f.37

## AKTIVITET

Veprimtaritë e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.41

**Bankieri**



BANKIERI është publikimi më i ri zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili do t'i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. BANKIERI do t'i japë lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

**Bankieri**

Nr. 1, Tetor 2011

**Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave**

**Për këtë numër punuan:**

Endrita Xhaferaj  
Bardhi Sejdarasi  
Klodian Tomorri  
Junida Katroshti

**Design & Layout:**

Sonila Krashi

**Fotograf:**

Gert Hoxha

**Bordi Editorial:**

Seyhan PENCAPLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm, NBG Bank

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank

Flutura VEIPI

Anëtare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Andrea GALATOULAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Alpha Bank

Ardian KAMBERI

Drejtor Ekzekutiv, First Investment Bank

Adrian CIVICI

Anëtar Këshilli Mbikqyrës, Banka e Shqipërisë

Elvin MEKA

Zv. Dekan / Përgjegjës i Dept. Financës, Fakulteti Ekonomik, Universiteti European i Tiranës

Elisabeta GJONI

Kryetare, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare

Hysen CELA

Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë


# Maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja

**Zgjuarsi** është të keni një llogari kursimi me shumë avantazhe, e cila shton në maksimum përfitimet tuaja.

Alpha **SMART** është një llogari e zgjuar, e cila kombinon normë interesi të lartë deri në 4.6% në Lek dhe mundësi për t'i përdorur paratë tuaja në çdo moment.

Për më tepër, një paketë analizash mjekësore falas.\*

Hapni tani një llogari kursimi Alpha **SMART** dhe maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja!



# ALPHA SMART

\*Për klientët që kanë balancë më shumë se 5.000 Euro ose ekuivalent Lek për 6 muaj



ALPHA BANK



## A është koha e “DASHURISË” së bankave me biznesin?!



Nga Bardhi Sejdarasi

Muajt e fundit ka patur disa ngjarje apo dukuri që kanë sjellë në fokus bankat e nivelit të dytë dhe qëndrimin ndaj tyre. Nuk kanë munguar as komentet dhe kundërkomentet, por as edhe shpjegimet profesionale të ekspertëve për çështjet e shtruar. Më e prekshmjat, pra edhe më e mediatizuarat ka qënë ngjarja që lidhet me vendimin e Raiffeisen Bank e cila kishte lajmëruar “sekuestrimit e pronave të grupit “A&B”, si pasojë e borxhit prej më shumë se 11 milionë euro që pronarët e kësaj kompanie i kanë bankës”, sipas njoftimit zyrtar të saj.

### Çfarë kishte ndodhur që kishte tërhequr vëmendjen mediatike?

Banka në fjalë, si çdo lloj banke tjetër në botë, kishte aplikuar zbatimin e një procedurë ligjore rutinë, të bazuar në ligj dhe në kontratë, ndaj një subjekti që ishte kredituar, por që kishte shkelur haptazi kushtet e kontratës. Sipas bankës, grupi i kredituar jo vetëm që nuk kishte paguar detyrimet për më shumë se një vit, por kishte refuzuar dhe refuzonte çdo lloj bashkëpunimi me bankën.

Ja çfarë kishte bërë banka: “Kemi siguruar disa ristrukturime gjatë vitit të kaluar për të reflektuar vështirësitë e kompanisë. Ukemi ofruar mundësinë pronarëve të kompanisë disa herë gjatë vitit të kaluar të bënin analizën financiare nga një vlerësues i jashtëm ndërkombëtar, kostot e të cilit do të mbulohehin nga banka. Kemi ofruar bashkëadministrimin e kompanisë me një ekspert ndërkombëtar të caktuar nga banka, një periudhë ndërprerje (grace period) për pagesën e borxhit dhe heqjes së gjithë penaliteteve – ofertë që gjithashtu u refuzua. Megjithatë, çdo përpjekje jona është refuzuar nga pronarët”, - sqaronte banka në një njoftim të saj të bërë publik në kohën e mediatizimit të skajshëm të kësaj ngjarjeje.

### Një ngjarje apo një dukuri!

Nuk duam të nxitohemi të themi se ajo ç’ka ka ndodhur me Raiffeisen Bank dhe klientin e saj është vetëm maja e ajzbergut e një dukurie që përbën shqetësim. Po e analizojmë këtë rast (që nuk është absolutisht i vetëm) për të deduktuar nevojën për të kuptuar dukurinë që

shoqëron këtë ngjarje. Bankat e nivelit të dytë dhe autoriteti që i mbikëqyr kanë qënë që në fillim të ditës të shqetësuara për problematikën që lidhet me çështjen e ekzekutimit të mjeteve të sigurimit të kredive bankare, thënë shkurt, të kolateralit.

Dy janë qëndrimet e mundshme: E para, të zgjidhen në mënyrë të menjëhershme vështirësitë që hasen në ekzekutimin e kolateralit për kreditë e dhëna nga bankat (dhe këtu përfshihen bankat, qeveria dhe gjyqësori). E dyta, që është në antitezë me të parën, bankat do të detyrohen të modifikojnë sjelljen, që do të thotë një qasje më konservatore në drejtim të kreditimit të ekonomisë.

Të dyja qëndrimet kanë kosto. Peshat e këtyre kostove është e ndryshme, por ajo që duket hapur është fakti se bankat dëmtohen njëjloj nga cilado mënyrë e zgjedhur për t’u zbatuar.

### Biznesi kundër bankave?!

Përfaqësues të biznesit vendas morën haptazi qëndrim publik kundër bankave, referuar rastit të mësipërm. U kërkua “gjetja e një gjuhe të përbashkët mes palëve”, madje u deklarua se “ka ardhur momenti që bankat të sillen ndryshe me sipërmarrjen, të njohin realitetin ekonomik të Shqipërisë dhe të shikojnë se çfarë mundësisht ka për ta zbutur në mënyrë të dyanshme këtë situatë të vështirë që ka vendi”, - siç citoi shtypi i ditës. Deklarimi preku edhe Bankën qendrore. Sipas deklaruësve, “Banka e Shqipërisë nuk duhet të jetë në anën e sipërmarrjes, nuk mund të jetë edhe kaq hapur sa ka qënë kohët e fundit në mbështetje të plotë të bankave”, - u tha në media.

### Çfarë u harrua të thuhet?

Duke e mirëkuptuar kërkesën për të zbutur në mënyrë të dyanshme situatën e vështirë të vendit, ata që atakuan bankat nuk thanë asnjë fjalë se kriza për të cilën flisnin dhe pas të cilës kërkonin “gjetjen e një gjuhe të përbashkët”, ishte më së pari një krizë financiare globale që dëmtoi bankierët dhe veprimtarinë bankare, sidomos imazhin e tyre.



Edhe pse bankat në Shqipëri, sipas deklarimeve zyrtare, nuk kanë aktive të rrezikshme në bilancet e tyre dhe as nuk janë përfshirë në huadhënie të pakujdesshme, nevoja për të pasur një sistem të shëndoshë dhe për të kontribuar në kreditimin e vazhdueshëm të ekonomisë dhe individëve, kërkonte dhe kërkon rritjen e kujdesit që bankat të mos përjetojnë kërcënime nga faktorë të brendshëm, sikundër mund të konsiderohej ekzekutimi i kolateraleve.

Bankat janë biznes, si çdo lloj biznesi tjetër. Çdo mangësi në hallkat e ndërmjetme të kreditimit dhe të shlyerjes së tij sjell rritje të kostos së financimit, dëmton imazhin e bankave, sjell impakt të drejtpërdrejtë në depozitat e qytetarëve.

Këto janë çështje që duhet t'i kuptojë biznesi që financohet, i cili përpara se të kërkojë “gjuhë


Bankat janë biznes, si çdo lloj biznesi tjetër. Çdo mangësi në hallkat e ndërmjetme të kreditimit dhe të shlyerjes së tij sjell rritje të kostos së financimit, dëmton imazhin e bankave, sjell impakt të drejtpërdrejtë në depozitat e qytetarëve.

të përbashkët” apo “zbutje” të krizës që mund të ketë përfshirë atë vetë, duhet të pyesë se sa kosto të rritur përfiton nga një financim që vjen nga kreditime me probleme, me presionin për rritjen e interesave të kredive dhe uljen e interesave të depozitave, me faktin se bankat po detyrohen të shtojnë provigjionimet (fondet rezervë për huatë e këqija) dhe po përqendrojnë vëmendjen në menaxhimin e kësaj situatë. Shtimi i kredive me probleme nuk dëmton kesisoj vetëm bankat, por edhe kredimarrësit, pra bizneset. Ndonëse niveli i kredisë me probleme është më i lartë tek bizneset, në krahasim me individët, përsëri bankat po preferojnë të kreditojnë sektorin privat.

Por duhet bërë e qartë se ka përfunduar “koha e dashurisë” mes bankave dhe bizneseve. Dhe kjo jo thjesht për shkak të rënies së fitimit të bankave, evidentuar edhe në shifrat e periudhës së deritanishme të këtij viti, por për arsyen se sipërmarrja shqiptare duhet të kuptojë se negociatat e ndërmarrja nga bankat për t'i dhënë një frymëmarrje më të madhe ecurisë së bizneseve, nuk mund të këmbëhet me pamundësinë e plotë për të shlyer detyrimin, me mungesën e ekzekutimit të kolateralit të lënë garanci posaçërisht për këtë qëllim.

Është koha që biznesi të përmirësojë menaxhimin e ndërmarrjeve të veta, duke ulur kostot e shpenzimeve dhe duke përballuar detyrimet kontraktuale me bankat për financimet e marra prej tyre. Çështja e kolateralit dhe e ekzekutimit të tij nuk është një çështje vetëm e bankave, por është një çështje publike, me impakt të gjerë dhe, të gjithë aktorët, duhet të këmbëngulin në ekzekutimin e mjeteve të sigurimit të kredive bankare. Nga kjo praktikë nuk ka të humbur, por vetëm të fituar...





## KOLATERALI dhe ndikimi në ekonomi

Cilat janë problematikat e ngritura nga industria bankare mbi hallka të caktuara të procesit të ekzekutimit të kolateraleve, duke filluar që nga rritja e rasteve që përballën në gjykata, përqasja e gjyqësorit ndaj këtyre proceseve, vështirësi të evidentuara në punën e përmbaruesve dhe përplasja në interpretimin e aspekteve të caktuara ligjore. Rruga drejt zgjidhjes së tyre.

Gjatë gjithë vitit të fundit mungesa e zgjatur e likuiditeteve për biznesin vazhdoi të vendosë bankat përballë vështirësive në rritje për mbledhjen e huave dhënë biznesit, të cilat prej shumë vitesh tashmë janë bërë promotor shumë i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë në vend. Pasi kanë përdorur të gjitha mënyrat e tjera për mbledhjen e huave dhe kanë konsumuar të gjitha opsionet e tjera për të mbajtur aktiv biznesin e huamarrësit, bankat janë detyruar të ndër marrin procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, një proces

fakt, ishte Banka e Shqipërisë që krijoi një grup ndërinstitucional për të nxitur diskutimet mbi zgjidhjet e mundshme të vështirësive në ekzekutimin e kolateralit.

Në këtë frymë Banka e Shqipërisë, në korrik 2011-ës, organizoi tryezën e rrumbullakët: “Kolaterali, kredia, tregu dhe ligji”, me pjesëmarrjen e aktorëve të sistemit bankar dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave, si dhe të institucioneve të tjera të përfshira në këtë proces si: Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, shërbimi përmbarimor gjyqësor publik e privat, etj. Kjo tryezë arriti të thotë shumë si dhe të shtrojë probleme për zgjidhje.

### Cilat janë çështjet e “hapura”?

Problematikat që lidhen me “ekzekutimin e mjeteve të sigurimit të pranuar si garanci për kreditë e dhëna”, pra kolaterali, janë të shumta. Më së paku, pasojë e mundshme në aktivitetin e kredihënies, është modifikimi i mundshëm i sjelljes së bankave në drejtim të një qasje konservatore në kreditimin e ekonomisë. Por ajo që evidentohet ka të bëjë me faktin se pengesa në ekzekutimin e kolateraleve nuk lidhen me tregun e pasurive të paluajtshme/luajtshme, por meshkaqerregullatore, organizative, si edhe me vetë zbatimin e ligjit procedural. Bankat kanë cituar gjyqësorin si një nga pengesat kryesore, por jo vetëm. Ato kanë shprehur pakënaqësi edhe mbi ushtrimin e detyrës nga përmbarimi por edhe mbi dispozita të caktuara ligjore. Këto probleme janë çështje ende të hapura në marrëdhëniet ndërinstitucionale, ku bankat kanë të pranishëm riskun e vazhdueshëm.

ky shumë i rëndësishëm për ruajtjen e një sistemi bankar të shëndetshëm dhe veçanërisht për mbrojtjen e parave të depozitorëve. Ndërkohë ky proces ka hasur shumë pengesa e problematika të cilat Shoqata Shqiptare e Bankave i ka ngritur përgjatë vitit duke iu drejtuar me shkresa e takime institucioneve të tilla si: Këshilli i lartë i Drejtësisë, Gjykatës së Lartë, Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por veçanërisht duke pasur mbështetjen e plotë të Bankës së Shqipërisë. Në

### Problemet në lidhje me hipotekat dhe pasuritë e paluajtshme

- Shfaqen probleme në pronësinë e objekteve, të cilat janë kolateral për kreditë dhënë nga bankat, në momentin e ristrukturimit ose refinancimit të huasë, apo në momentin e ekzekutimit të kolateralit, probleme për të cilat bankat nuk kanë qenë në dijeni në momentin e bllokimit për kolateral të këtyre objekteve.
- Ka pasaktësi në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe mangësi informacioni në kartelat e pronësisë, si edhe probleme me mosrespektimin apo deformimin e ligjit material.
- Është e domosdoshme të mundësohet siguri juridike në regjistrin publik të pronave në mënyrë që palët të ushtrojnë të drejtat e tyre pa u ndier të cënuar. Si pasojë e pasigurisë bankat detyrohen të shtrëngojnë kushtet e tyre të kreditimit, çka ndikon drejtpërdrejtë në mosfurnizimin e tregut me fonde.
- Për të gjitha sa më sipër AAB dhe përfaqësues të Komitetit të Saj Ligjor patën një takim me Kryerregjistruesin dhe përfaqësues të tjerë të Zyrës Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku diskutuan gjerësisht rastet konkrete dhe problemet që hasen, dhe ku ZQRPP u angazhua për hartimin e një udhëzuesi për ZVRPP-të me qëllim rregullimin e një pjese të problematikave.



Mjaft me lojëra

**Blijeni dhe  
shijojeni tani  
shtëpiënë tuaj  
të vërtetë**



4 22 66 288 | [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)

**Kredi për Shtëpi nga BKT**  
Miratim në kohë rekord dhe  
interesat më të ulta në Lekë



Dr. Ioannis Kougionas  
Nënkryetar AAB

## Kougionas: Propozimet tona

Fjala në tryezën e rumbullakët: “Kolaterali, kredia, tregu dhe ligji”

Bankat kanë kredituar vazhdimisht bizneset shqiptare dhe janë të angazhuara për ta bërë këtë kreditim në të ardhmen, duke qenë një promotor shumë i rëndësishëm i zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë në vend.

Në një kontekst të tillë, një çështje shumë e rëndësishme është dhe ekzekutimi i kolateralit. Kryerja e një procesi të shpejtë dhe të suksesshëm të ekzekutimit të kolateralit është i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm për ekzistencën e një sistemi bankar të shëndoshësi dhe mëse i domosdoshëm për funksionimin e një ekonomie konkurruese. Bankat janë të detyruara të mbrojnë paratë e depozituesve dhe të aksionerëve të tyre.

Privatizimi i shërbimit përmbartimor pati një ndikim pozitiv në lehtësimin e procedurave të ekzekutimit. Pavarësisht nga përpjekjet e bankave dhe përmbartuesve për të përshpejtuar procedurat e ekzekutimit

dhe vetë ekzekutimin e kolateralit, nga përputhje me dispozitat ligjore, ato janë përballur me vështirësi të vazhdueshme në këtë proces. Shumë nga këto vështirësi lidhen me proceset dhe vendimet gjyqësore për pezullimin e veprimeve përmbartimore, duke shkaktuar vonesa dhe pengesa në procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit.

Gjithashtu, probleme të ndryshme janë krijuar nga mungesa e dispozitave ligjore, apo keqinterpretimi i dispozitave ekzistuese, që lidhen me procesin e ekzekutimit të kolateralit.

Përrrjedhojë, gjykimet janë zgjatur tej afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe gjykatat kanë vendosur masa të sigurimit të padisë, bazuar në kërkesën e debitorit, pa përmbushur kushtet e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile.

Shoqata Shqiptare e Bankave, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të ekzekutimit, ka propozuar si vijon:

1. Amendimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.
2. Amendimin e kuadrit ligjor që rregullon regjistrimin e pasurive të

paluajtshme, duke pasur parasysh se shumë nga problemet me të cilat po përballen bankat janë të lidhura me çështjet e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.

3. Shqyrtimi i mundësisë për të krijuar një grup apo seksion të gjyqtarëve, të cilët të mund të angazhohen me çështjet gjyqësore që lidhen me:

- pretendimet ndaj veprimeve përmbartimore,
- nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit,
- për të lehtësuar bankat gjatë fazës së zbatimit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit.

4. Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e situatës së ekzekutimit të kolateralit, mund të konsiderohet një amendament, lidhur me mënyrën e pagesës për përmbartuesit publikë dhe privatë, konkretisht: në vend që të paguhen paraprakisht, ata të mund të paguhen në përqindje të shumave të mbledhura (rikuperuara) pas, ose gjatë procesit të ekzekutimit (në formën e një tarife suksesi). Në këtë mënyrë, përmbartuesit do të jenë të motivuar për të përmbushur detyrat e tyre plotësisht, duke arritur dhe rezultate konkrete.

## Fullani: Biznesi duhet të rikalibrojë pozicionin e tij



“...vështirësitë duket se nuk janë vetëm të natyrës ligjore, por shpeshherë, dalin në pah në sajë të sjelljeve burokratike të institucioneve të përfshira. Sigurisht që bankat janë krijuar për të dhënë kredi, por, para së gjithash, duhet të mbajmë parasysh se rëndësi më të madhe se kreditimi i një biznesi të veçantë apo se portofoli i një banke të veçantë, përbën stabiliteti i depozitave të popullatës; të individëve të thjeshtë. Për më tepër biznesi duhet të rikalibrojë pozicionin e tij në raport me zhvillimet e fundit, si në ekonominë e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme. Ai duhet të synojë produktivitet më të lartë, kryesisht nëpërmjet evidentimit të të gjithë avantazheve krahasuese, në raport me spektrin e ndryshimeve globale.”

(Nga fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në tryezën e rumbullakët: “Kolaterali, kredia, tregu dhe ligji”)



## Bode: Çështja e kolateralit është një çështje publike

“...Tani që kriza globale po shkon drejt uljes së presionit të saj dhe presioni i faktorëve të jashtëm mbi banka ka rënë ndjeshëm, ne të gjithë duhet të bëjmë çmos që të mos lejojmë faktorë të brendshëm të kërcënojnë stabilitetin e bankave. Ne nuk duhet të lejojmë që një proces ekzekutimi i ngathët dhe shpesh i paqartë të bëhet shkak për të alternuar negativisht vullnetin e

bankave për të kredituar ekonominë. Në këtë kontekst, problematika që shoqëron ekzekutimin e mjeteve të sigurisë të kredive bankare, apo thënë përmblodhtas “kolateralin”, duhet adresuar me shpejtësi dhe zgjidhjet duhet të vihen në efikasitet sa më shpejt.

...Çështja e kolateralit është një çështje publike. Së pari sepse lidhet me një sistem biznesi, i cili është tërësisht specifik. Dhe kur është fjala për të ekzekutuar kolateralin, nuk është fjala për të mbrojtur interesat e kapitalit të një banke, të një biznesi privat, por ka

një impakt të gjerë në publik, interesin për të mbrojtur depozitat e qytetarëve të vendit. ...Por mendoni se ç’mund të ndodhë nëse sistemi financiar, sistemi bankar do të vendoste në pikëpyetje të mëdha besueshmërinë e tij. Do të jetë bota e biznesit që do të paguajë taksa shtesë për të kompensuar ato kosto që vijnë nga një degradim financiar i vendit në tregjet globale.”

*(Nga fjala e z. Ridvan Bode, Ministër i Financave, në tryezën e rrumbullakët: “Kolaterali, kredia, tregu dhe ligji”)*



## Brikena Kasmir, Zv/ Ministre e Drejtësisë

Liberalizimi i shërbimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, praktikë kjo e ndjekur edhe nga disa vende të Evropës, ka krijuar vlerë të shtuar në drejtim të shpejtësisë,

debuokratizimit, efikasitetit dhe rritjes së cilësisë për shkak të konkurrencës. Ministria e Drejtësisë, duke parë ecurinë e shërbimit të përbarimit, evidentoi: a) përmirësim të kundërshtimit të veprimeve përbarimore dhe moszvarritje të procesit të ekzekutimit në gjykata; b) zgjerim të titujve ekzekutivë

me përfshirjen e produkteve të overdraft-eve dhe kartave të kredisë; c) rritje të aksesit nëpërmjet njoftimit dhe afishimit të listës së përbaruesve; d) rregullim i marrëdhënieve kreditor - përbarues në drejtim të qartësisë dhe saktësisë; dhe e) sigurim të padisë edhe për kreditorin sikundër për debitorin.



## Artan Zeneli, Kryetar i Gjykatës së Tiranës

Përsa i përket “kundërshtimit të veprimeve përbarimore”, Z. Zeneli hedh poshtë pretendimin se kësaj mase i ka humbur qëllimi për sa kohë është e vetmja e drejtë e pamohueshme e debitorit, ndërkohë që sipas tij, duke qenë se lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit nuk ka kaluar në një proces

gjyqësor, titulli, pra kontrata mund të zgjidhet të trajtohet nga gjykata. Kjo mund të shmangët nëse titulli ekzekutiv do të përmbante në mënyrë të mirë përcaktuar detyrimin. Në lidhje me “masën për sigurimin e padisë”, ai u shpreh se ka nevojë për unifikim praktikash.


## Në vijim.....

Grupi i punës ndërinstitucional i krijuar nga Banka e Shqipërisë u zgjerua me përfshirjen në të edhe të përfaqësuesve të bankave dhe vazhdoi punën drejtuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave me synim përcaktimin e veprimeve të mëtejshme për t’u ndërmarrë nga secili institucion në drejtim të realizimit të masave të parashtruara në Forum apo dhe të tjerave të nevojshme për adresimin e shqetësimeve të përbashkëta.

Në mënyrë të përgjithshme plani i veprimeve është fokusuar në këto drejtime:

- Unifikimi i praktikave gjyqësore nga Gjykata e Lartë për çështje gjyqësore të cilat interpretohen e trajtohen në mënyra të ndryshme nga gjykata të ndryshme.

- Propozimin e ndryshimeve të nevojshme në Kodin e Procedurës Civile që lidhen me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, në bashkëpunim me EURALIUS.
- Konsiderimi me prioritet dhe suporti i bankave në drejtim të trajnimeve të gjykatësve me qëllim njohjen dhe zbatimin e legjislacionit që lidhet me ekzekutimin e kolateralit, por edhe njohja më e thellë e produkteve financiare në përgjithësi
- Ndërtimi i një fushatë sensibilizuese me qëllim edukimin financiar të bizneseve dhe individëve dhe organizimi i Forumeve të përbashkëta apo tryezave të rrumbullakëta me organizatat e Biznesit me qëllim njohjen e produkteve në tërësi të bankave tregtare.



# FINANCIMI ME OBLIGACIONE

një alternativë e re për financimin e shoqërive tregtare



Nga Dr. Elvin Meka  
Zv. Dekan & Përgjegjës i  
Departamentit të Financës  
Fakulteti Ekonomik,  
Universiteti Europian i Tiranës

Ekzekutimi i kolateralit, përkufizohet si akti ekstrem dhe fundor i bankës, në kushtet e pamundësisë praktike nga ana e bankës për të rekuperuar huatë me probleme arkëtimi, nga klientët që nuk shlyejnë detyrimet kundrejt saj. Ky fenomen mbetet një zhvillim i një natyre disi të pazakontë, por me të cilën do të vijojë të përballët biznesi shqiptar tani e tutje. Kjo problematikë e mprehtë, e kombinuar me efektet goditëse të krizës globale financiare dhe shtrëngimin e kushteve të huadhënies nga sistemi bankar në tërësi, e ka vendosur biznesin shqiptar përballë një sfide të vërtetë, lidhur me sigurimin e qëndrueshëm të burimeve të financimit, veçanërisht për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

## Kriza e sistemit dhe shkak - pasoja e sjelljes së bankave

Është tashmë e njohur se, pavarësisht goditjes së tërthortë që mori ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar nga kriza globale ekonomike e financiare dhe, ndërhyrjes energjike të Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e shëndetit financiar të sistemit bankar shqiptar, nuk u arrit të shmangej përballja e biznesit me një sjellje konservatore të bankave në kredidhënie dhe me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik. Praktikisht, i gjithë sistemi bankar vijoi të shtrëngonte kushtet e kredidhënies, dhe kjo fillimisht si një kundërpërgjigje logjike ndaj

një situatë të vështirë e të pasigurt likuiditeti, e shkaktuar nga tërheqja e depozitave dhe paniku në tregjet ndërkombëtare financiare, në kulmin e krizës globale financiare, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008.

Nga ana tjetër, sjellja gjithnjë e më konservatore e bankave pasqyroi dhe shqetësimin e tyre real për rënien e vazhdueshme të cilësisë së portofolit të kredisë. Përmbledhtazi, rezultati i goditjes së ekonomisë dhe biznesit shqiptar nga kriza globale financiare mund të përmbledhet në: (1) rritjen e huave me probleme dhe (2) shtrëngimi në bllok i kredidhënies nga ana e sistemit bankar. Logjikshëm që, këto dy rezultate shërbejnë në mënyrë të shkëmbyeshme si shkak-pasojë për njëri-tjetrin.

Goditjet e krizës globale, megjithëse të tërthorta, do të materializoheshin në formën e uljes së konsumit të brendshëm, qoftë ky për mallra të qëndrueshëm e jo të qëndrueshëm, pakësimit të


likuiditetit, rënies së qëndrueshme të dërgesave të emigrantëve dhe uljes së ritmit të investimeve në makineri e pajisje (sipas Grafikut më poshtë), që normalisht mbështesin zgjerimin e aktivitetit të biznesit në përgjithësi (kryesisht atij prodhues e të shërbimeve). (Grafik 1)

Të gjithë këta faktorë (kryesisht makroekonomikë), mbitëcilët kapatur një ndikim të madh pikërisht kriza globale ekonomike e financiare, kanë sjellë pashmangshmërisht dhe uljen e aftësisë paguese të huamarrësve në banka dhe rrjedhimisht, rritjen e huave me probleme. (Tabelë 1)

Për vetë modelin e zhvillimit të sistemit financiar shqiptar, financimi i ekonomisë dhe bizneseve mbetet thuhajse tërësisht një *domain* i bankave. Kjo pasi, për vetë peshën që zënë aktivitetet e bankave dhe ndërmjetësimi bankar brenda sistemit financiar (mbi 94%), e vendos sistemin bankar në pozicionin e ofruesit thuhajse unik të financimit për biznesin.

vijon në fq. 15 ►►

Grafik 1. Ecuria e huasë për biznes në Shqipëri T4 2008 - T2 2011<sup>1</sup>



Burimi: Banka e Shqipërisë

<sup>1</sup> I paaxhustuar sipas kursit të këmbimit.

# Ne shesim **Ar 24 karat** dhe **Monedha të çmuara.**



☎ 04 22 34 096 @ [www.bankcredins.com](http://www.bankcredins.com)

Sot CREDINS bank ofron një shërbim të ri. Tashmë ju mund të blini ar 24 karat dhe monedha të çmuara. Më konkretisht:

- Ar të cilësisë maksimale, 24 karat, të certifikuar me origjinë Austriake. Ky Ar (Gold Bars) ofrohet në prerje të ndryshme si 1g, 2g, 5g, 10g, 20g, 50g, 100g, 250g, 500g, 1000g, 12.5 kg. Çmimi që ofrohet është i njëjtë me bursën botërore, transparent në çdo moment për t'u kontrolluar.
- Monedha Ari, Gold Sovereign Coins dhe monedha Angleze Elizabeth II, prerje të vjetra dhe të reja, që njihen në gjithë botën për vlerën e tyre. Monedhat e blera tek CREDINS bank janë të tregtueshme kudo në botë. Gjatë viteve monedhat e arit përfitojnë edhe vlerë numizmatike duke rritur më shumë vlerën e tyre.

CREDINS bank, shtojini vlerë pasurisë tuaj.

Tabelë 1. Ecuria e huave me probleme në Shqipëri T4 2008 – T2 2011

T4 2008	T1 2009	T2 2009	T3 2009	T4 2009	T1 2010	T2 2010	T3 2010	T4 2010	T1 2011	T2 2011
6.6	7.6	8.7	9.7	10.5	11.7	12.2	13.8	13.8	14.7	17

Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) - (sipas SNK-ve)

Kështu, në mungesë të kanaleve apo alternativave të tjera konkurruese të financimit, të ndryshme nga huadhënia bankare, biznesi ka qenë i “detyruar” të pranojë kushtet e shtrënguara, të ofruara thuajse në unison nga të gjitha bankat e sistemit, si dhe ofertën e kufizuar për huadhënie nga bankat, gjatë gjithë periudhës 2009-2010. Për rrjedhojë, biznesi shqiptar e pati të pamundur të tërhiqte likuiditete nga burime të ndryshme, në formë dhe origjinë, nga kredia apo kanalet bankare, duke zbutur në këtë mënyrë shtrëngimin e kushteve të kredisë bankare, si dhe për të amortizuar efektet goditëse të krizës globale financiare, si brenda sistemit financiar ashtu dhe brenda ekonomisë reale.

## Financimi me obligacione - një alternativë e re për financimin e shoqërive tregtare

Mungesa e përdorimit të këtij instrumenti nga ana e biznesi shqiptar është deri diku i justifikuar dhe kjo për disa arsye, si:

- Stadi i zhvillimit ekonomik të vendit dhe kohës së nevojshme për konsolidimin e instrumentit të huasë bankare, brenda mekanizimit të funksionimit të ekonomisë së tregut;
- Stadi i zhvillimit institucional dhe organizativ të biznesit të mesëm e të madhshqiptar. Kështu, këto biznese janë në fazat e para të zhvillimit të tyre, në kontekstin e ekonomisë shqiptare, si një ekonomi e re kapitaliste, e si të tilla, ato mund të klasifikohen si shoqëri në rritje, të cilat përgjithësisht zgjedhin burime private dhe jo publike për financim, pasi është më e lehtë rinegociimi i një huaje me probleme me një (ose disa) bankierë, sesa të negociohet me qindra mbajtës obligacionesh, për të ristrukturuar kushtet dhe afatet e një obligacioni të emetuar publikisht;
- Efekti “përrjashtues” që luajnë investimet e huaja të drejtpërdrejta,

duke qenë pjesa dërrmuese e investimeve të huaja të rëndësishme në Shqipëri vijjnë nga shoqëri të listuara në bursa apo me akses të lehtë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit;

- Mungesa e klasifikimit të mundshëm të këtyre titujve nga agjenci të specializuara dhe kostot që shoqërojnë jo vetëm procesin e emetimit të tyre, por dhe detyrimet për raportim të vazhdueshëm.

Pavarësisht nga sa më lart, gjykohet se momenti aktual është mëse i përshtatshëm për shoqëritë shqiptare, për të konsideruar emetimin e obligacioneve, duke patur parasysh një sërë konsideratash favorizuese që ekzistojnë për to, si më poshtë:

- Obligacionet shërbejnë si një instrument kompensues për luhatjet në ofertën e përgjithshme për fonde nga jashtë biznesit. Megjithatë financimi me obligacione varet nga cikli ekonomik, luhatja e tyre nuk është aq e theksuar sesa ajo e huave bankare
- Ekzistenca dhe përdorimi i instrumentit të obligacioneve të shoqërive aksionere kushtëzon një rritje më të moderuar të paaftësisë paguese të bizneseve të mëdha (huaja me probleme e të cilëve rrit në amplitudë më të madhe e më me shpejtësi fondin e provigjioneve dhe humbjet e bankave sesa kreditë me probleme të individëve), pasi në momentet me vështirësi likuiditeti ato mjaftohen kryesisht vetëm me pagesat e kuponave dhe jo me shlyerje të principali (si në rastin e kësteve të huasë);
- Në Shqipëri ekziston kuadri ligjor bazë, (ligji nr.10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”), që u mundëson shoqërive tregtare shqiptare të emetojnë lloje të ndryshme obligacionesh;
- Për bankat krijohet një alternativë e re investimi, disi e ndryshme nga huaja bankare, si dhe mundësi për nxjerrjen e përfitimeve nga komisionet apo shërbimet me vlerë

të shtuar për klientët e tyre në tregun e letrave me vlerë;

- Uljen e rrezikut sistematik, pasi bankat janë institucione me përdorim të madh të levës financiare dhe funksionimi i tregut të obligacioneve të shoqërive tenton balancimin e këtij tregu me atë bankar, duke zvogëluar natyrshëm këtë rrezik;
- Sigurimi i alternativave të investimit për fondet e pensione dhe shoqëritë e sigurimeve, duke u mundësuar këtyre të fundit krijimin e produkteve dhe skemave afatgjata të kursimit dhe investimit;
- Zhvillimi i tregut të obligacioneve do të ishte një element përbërës kyç i tregut të kapitalit, prej të cilit do të mund të financoheshin një pjesë e mirë e projekteve të rëndësishme të infrastrukturës, duke mos lejuar eksportimin e kapitaleve në formë investimesh jashtë vendit.

## Në konkluzion

Bizneset shqiptare mund dhe duhet të konsiderojnë si domosdoshmëri për vijueshmërinë e financimit të qëndrueshëm dhe eficient të aktivitetit të tyre, emetimin e obligacioneve. Kjo do të ishte një sipërmarrje me përfitim të dyanshëm (biznes-banka), në këndvështrimin e ngushtë ekonomiko-financiar, por dhe me përfitime të mëtejshme, në kuadër të zhvillimit të tregut financiar dhe ekonomisë në tërësi.

## Një pyetje që pret përgjigje:

**A duhen konsideruar obligacionet si një model i ri financimi afatgjatë nga bankat dhe bizneset shqiptare?**

Na shkruani në Redaksinë e BANKIERI-t!  
bankieri@aab-al.org



## STRATEGJI KOMBËTARE për edukimin financiar

Shoqata e Bankave mbështet përshtatjen e një plani kombëtar për informimin dhe zgjerimin e njohurive financiare të publikut.

Botë e sotme financiare është shndërruar në një labirint kompleks, ku shumë njerëz e gjejnë të pamundur të notojnë. Dhe ky nuk është problem vetëm i vendeve të pazhvilluara, por të njëjtin shqetësim ndajnë sot edhe ekonomitë më të fuqishme të botës, aty ku industria financiare ekziston prej qindra vjetësh.

Një studim i vitit 2008 në Itali tregoi se rreth 33 për qind e popullsisë nuk mund të lexojnë deklaratat e bankave, të llogarisnin ndryshimet në fuqinë blerëse apo të dallonin mes tipeve të ndryshme të kredive dhe për rrjedhojë të llogarisnin risqet mbi to.

“Ky fenomen ekziston thuajse në të gjitha vendet e OECD-së,” vëren Franco Passacantando, i “Banca d’Italia”. Me të vërtetë. Në Mbretërinë e Bashkuar një në dy individ që kanë llogari bankare nuk është në dijeni për normën aktuale të interesit. Në Shtetet e Bashkuara, 50 për qind e atyre që janë në koleji dhe në shkollat e larta nuk e kuptojnë në mënyrë korrekte se si të menaxhojnë borxhet në kartat e tyre të kreditit dhe vetëm 17 për qind janë të aftë të vlerësojnë kthimet e ndryshme nga kursimet në letrat me vlerë apo llogaritë e kursimit.

Njohuritë e konsumatorëve shqiptarë në fushën financiare janë pak a shumë në të njëjtat nivele me vendet e rajonit për disa tregues bazë, por më të ulëta në disa tregues të tjerë më kompleksë

### Shqipëria

Një vëzhgim i kryer në terren nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me ekspertë të Banca d’Italia, tregon se njohuritë e konsumatorëve shqiptarë në fushën financiare janë pak a shumë në të njëjtat nivele me vendet e rajonit për disa tregues bazë, por më të ulëta në disa tregues të tjerë më kompleksë. Sipas studimit, publiku në Shqipëri ka njohur pak a shumë të barabarta me rajonin për disa koncepte si rreziku dhe kthimi, inflacioni apo dhe diversifikimi. Por shqiptarët, tregon vëzhgimi, kanë njohuri më të pakta në disa koncepte më komplekse si vlera në kohë e parasë, llogaritja e interesit dhe principalit apo dhe interesi i përbërë. Për më tepër vëzhgimi konfirmon një shkallë të ulët ndërgjegjësimi financiar në publik. Përqindja e qytetarëve shqiptarë që përgjigjen se mbikëqyrin vetë ngushtësisht punët e tyre financiare është 20 pikë më e ulët se sa mesatarja e vendeve të rajonit.





Edhe programimi i financave ka të njëjtën tendencë. Vetëm 12 për qind e të intervistuarve në Shqipëri thonë se vendosin objektiva financiar afatgjatë dhe përpiqen t'i arrijnë ato. Mesatarja e rajonit është 33 për qind.

### Ndërgjegjësimit në rritje

Në një treg me konsumatorë të keqinformuar nuk fiton askush. Padituria nuk është e dëmshme vetëm për konsumatorët. Ajo godet edhe vetë bizneset dhe madje edhe industrinë. Vetë bankat janë të ndërgjegjshme për këtë.

Miratimi i një plani strategjik për një arsimim të strukturuar dhe mbarëkombëtar financiar do të jetë një hap i rëndësishëm për të garantuar koordinimin e të gjitha përpjekjeve dhe përgjegjësi që ndajnë palët e interesuara qofshin këto publike apo private për përmirësimin e edukimit financiar në Shqipëri

“Edukata financiare i ndihmon konsumatorët të marrin vendime më të informuara dhe i mbron nga rreziqet. Një nivel i mirë i edukatës financiare çon drejt stabilitetit financiar dhe zhvillimit ekonomik,” vëren Shoqata Shqiptare e Bankave. Gjatë dekadës së fundit bankat private në Shqipëri kanë ndërmarrë një sërë iniciativash që kanë patur në fokus edukimin financiar të konsumatorëve, të cilat kanë qenë tërheqëse dhe të orientuara nga tregu. Fletëpalosje, publikime të ndryshme, prezantime, që promovojnë një proces mësimi interaktiv kanë qenë disa prej tyre. Për më tepër, Shoqata e Bankave ka qenë e përfshirë dhe madje edhe nismëtare e fushatave për informimin dhe edukimin financiar të publikut në bashkëpunim me organizima të tjerë si IFC apo ASD. Nga ana tjetër edhe vetë rregullatori, Banka Qendrore, e ka vendosur edukimin financiar si një nga prioritetet e saj. “Në këtë drejtim, do të doja të veçoja kontributin e fundit që Banka e Shqipërisë i dha nxënësve të shkollave të mesme nëpërmjet librit: “Financat personale në duart tuaja”, një publikim i ideuar për shkollat e mesme, si pjesë e kurrikulës me zgjedhje që bëjnë nxënësit vetë,” thotë guvernatori Ardian Fullani.

Të gjithë janë të vetëdijshëm se rritja e nivelit të edukimit financiar dhe vetëdijes konsumatore po bëhet një instrument i domosdoshëm për konsumatorët që jetojnë në një treg financiar të globalizuar gjithmonë e më shumë të sofistikuar. “Eksperiencia ndërkombëtare tregon se edukimi financiar konsiderohet si prioritet absolut në shumë vende, shumë prej të cilave madje kanë adoptuar strategji kombëtare për zgjerimin e njohurive financiare të publikut. Shoqata e Bankave mendon se edhe Shqipëria duhet të ndjekë këtë shembull. “Miratimi i një plani strategjik për një arsimim të strukturuar dhe mbarëkombëtar financiar do të jetë një hap i rëndësishëm për të garantuar koordinimin e të gjitha përpjekjeve dhe përgjegjësi që ndajnë palët e interesuara qofshin këto publike apo private për përmirësimin e edukimit financiar në Shqipëri,” thotë Shoqata.

Klodian Tomorri

## Nga “PHISHING” tek “VISHING”



### KUJDES!

## Ja si mund t'iu vjedhin informacionin dhe paratë!

Përsosja e mënyrave të grabitjes, rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike informatike



Nga: Roland Tashi  
Zëvendës Kryetar i Komitetit të  
AAB-së për Sigurinë Bankare

P prej kohësh është prezent, qarkullon e përdoret nga “mjeshttrat” e ndërhyrjeve dhe grabitjeve nëpërmjet rrjeteve informatike fenomeni “phishing”, i cili tashmë është i njohur dhe për të ka informacion.

Megjithatë, me “phishing” (nga anglishtja, “to phish”, me peshku/peshkuj) kuptojmë një aktivitet abuziv, ku nëpërmjet teknikave inxhinierike tentohet të “peshkohen” viktimat dhe të sigurohet informacion i nevojshëm lidhur me të dhënat personale të një përdoruesi, duke shfrytëzuar rrjetet informatike të komunikimit. Në këto raste, përdoruesit tentohet t'i merren kodet e identifikimit, të dhënat e llogarive bankare, të dhënat e kartave të kreditit, etj, e pas kësaj t'i “shkarkohen” apo “transferohen” paratë që gjenden në këto llogari personale.

### “Trendi” i abuzimit informatik

Grabitja dhe abuzimi informatik ka evoluar edhe më tej, po përsoset dhe “përmirësohet” si pasojë e zhvillimeve teknologjike. Nga “phishing”, në teatrin e grabitjeve inteligjente, apo grabitjeve “të ftohta”, siç mund t'i quajmë ndryshe, po përdoret edhe fenomeni “Vishing” që padyshim shoqëron dhe ndjek aplikimet e reja informatike, jo vetëm në sistemin bankar e atë financiar, por edhe më gjerë, deri në nivelin e përdoruesve të zakonshëm të rrjeteve informatike.

Fenomeni i grabitjeve i tipit “vishing”, filloj të shfaqej për herë të parë në Amerikë në vitin 2006, duke vazhduar më vonë në Angli e duke avancuar



Zhvillimet e teknologjisë informatike dhe aplikimi gjithmonë në rritje në banka për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj klientëve, po shoqërohet edhe me fenomenet e tentativat abuzive për të përftuar dhe “grabitur” para e informacion nëpërmjet rrjeteve informatike, pa vajtur e rrezikuar brenda ambienteve të saj.

gradualisht në të gjithë Evropën, duke përmirësuar në vazhdimësi cilësinë e teknikave të mashtrimit. Përdoruesit e kësaj forme mashtrimi, preferojnë komunikimin VoIP (telefoni nëpërmjet protokollit të internetit), për arsye se ky komunikim në raport me telefoninë tradicionale (PSTN) ka më shumë avantazhe : - kosto shumë të ulët për bisedë, sidomos për komunikime në distanca të mëdha, - kosto të ulët në infrastrukturë, mjafton vetëm lidhja në një rrjet informatik, etj.

### Si ta kuptojmë dhe si të mbrohemi nga “Vishig”?

“Vishing”, është bashkim terminologjik i “VoIP” (Voice Over Internet Protocol - telefoni nëpërmjet protokollit të internetit) dhe “Phishing”. Me këtë fenomen kuptojmë ndërtimin e një praktike abuzive grabitje, e cila shfrytëzon shërbimet e telefonisë VoIP, duke simuluar një “call center” (qendër telefonike për kujdesin ndaj klientit) të një banke. Në këtë qendër të simuluar, klientët, në këtë rast viktimat, mashtrohen nga një i shtirur si operator i bankës, i cili tenton të përftojë sa më shumë informacion lidhur me të dhënat e tyre bankare.

Ashtu si mashtruesi i tipit “phisher”, edhe ai i tipit “visher”, shfrytëzon komunikimet e postës elektronike, por në një proces më të sofistikuar dhe “bindës” për klientët e paditur.

Metodat dhe formatet e mashtrimit janë të ndryshme, në vartësi edhe të informatizimit të proceseve, por le të ndjekim logjikën dhe fazat e këtij fenomeni.

- Ideatorët dhe aplikuesit e kësaj teknike, i dërgojnë individëve nëpërmjet postës elektronike (e-mail) mesazhe të ngjashme në

grafikë, logo dhe përmbajtje, me atë të bankës, shoqërisë apo kompanisë ku këta individë janë klientë dhe kanë llogaritë e depozitat e tyre.

- Mesazhet në e-mail simulojnë “njoftime” për klientin lidhur me: llogarinë e tij rrjedhëse, maturim të depozitave, rinovim të interesave, shlyerjen e debive, ndryshim të kushteve të marrëdhënieve me bankën, përfundimin e afatit të përdorimit të kartave si dhe situata të tjera të ngjashme me veprimtarinë bankare.
- Mesazhi njofton gjithashtu klientin se për çështjen e informuar duhet të kontaktojë me “call center” të bankës nëpërmjet mënyrës dhe numrit telefonik të shpjeguar me shumë delikatesë në fund të mesazhit.

Në fakt, numri telefonik që serviret në masazhin e dërguar me e-mail prej “visher”-it, nuk i përket “call center” (qendrës për kujdesin ndaj klientit) në bankë, por një centrali të simuluar, ku një operator shumë elokuent dhe i kulturuar tenton të përftojë nga klienti i peshkuar të dhënat personale të tij në raport me bankën.

Të dhënat e grumbulluara, përpunohen dhe administrohen nga “mjeshtrat” e mashtrimit e më pas përdoren për tërheqjen e parave, transferimin e tyre ose si të dhëna, të cilat mund të shërbejnë për dëmtimin dhe goditjen e identitetit të një individi.

“Visher” - i, mund të përdorë edhe një sistem thirrjesh automatike, për të peshkuar viktimat potenciale. Në momentin që dikush nga viktimat e peshkuar i përgjigjet thirrjes telefonike, sistemi riprodhon një mesazh i cili “njofton” klientin se ka probleme me llogarinë e tij bankare, me kartën e kreditit, etj,

dhe i kërkon atij se për këtë duhet të kontaktojë numrin telefonik të servitur në mesazh. Numri i servitur është pikërisht numri i “visher”-it, i cili në rast se ti e telefonon, fillon nga pyetjet mashtruese për të përftuar sa më shumë informacion konfidencial lidhur me llogaritë apo marrëdhëniet e tjera me bankën.

### “Skema” perfekte e mashtrimit

Fenomeni i vjedhjes së informacionit dhe grabitjeve nëpërmjet “call center” të falsifikuara (jo ekzistente) është në rritje. Mjeshtrat e mashtrimit kanë kuptuar se viktimat nuk arrijnë të dallojnë nivelin e rrezikut që ekziston ndërmjet përgjigjes në e-mail dhe kryerjes së bisedës telefonike me një “operator” të bankës dhe, për thjeshtësi, preferojnë të zgjedhin bisedën. Padyshim që komunikimi gojor telefonik, sidomos kur bashkëbiseduesi është i kulturuar, elokuent, orator, bindës, korrekt dhe kompetent, ndikon shumë në rezultatin e mashtrimit. Vazhdimi i bisedës, ndërthurja e saj me problemet dhe shqetësimet e ditës, me marrëdhëniet sentimentale etj, ndikon në tundimin dhe çoroditjen e viktimës.

Këta mashtrues, që ngrenë kurthe e prita “informatike”, shëtisin në internet, të padukshëm, të pamëshirshëm, duke përitur momentin e duhur për të sulmuar sistemin tënd. Veprojnë me taktikën e grabitqarëve të uritur në Savanë. Në rast se viktimat ka aftësi ta identifikojë grabitësin, ata zbrapsen, por nuk tërhiqen nga sulmi duke vazhduar të jenë të bindur se do të kapin viktimat të tjera, të lodhura dhe të pamundura për të dalë nga kurthi.

Shpjeguar se nëpërmjet komunikimit telefonik në internet, në rast se nuk kemi informacionin e

duhur dhe nuk jemi të vëmendshëm, jemi të ekspozuar ndaj rrezikut të dhënies së informacionit individual, konfidencial bankar personave të quajtur “visher”, të cilët komunikojnë të kamufluar si operatorë të një qendre kujdesi ndaj klientit në bankë.

Normalisht lind pyetja: Si e kupton “visher” - i se viktimat e kapur ka një llogari bankare?

Mashtuesi nuk ka asnjë informacion paraprak se viktimat që ai ka peshkuar ka një llogari bankare, llogari rrjedhëse, kartë krediti apo marrëdhënie të tjera biznesi me bankën. Ai tenton që nëpërmjet postës elektronike apo thirrjeve telefonike, kërkesa apo informacioni mashtues i përgatitur t’i shkojë një numri sa më të madh individësh me shpresën dhe probabilitetin se dikush që ka llogari apo shqetësim me bankën, do të përgjigjet për ta vazhduar më tej historinë e mashtimit. Në psikologjinë e krimit të grabitjes, aplikuesit e krimit informatik gjykojnë se është më e thjeshtë dhe me “ekonomike” të vjedhësh informacion nëpërmjet internetit se të mashtrosh e të vjedhësh xhepat apo portofolin e një viktime. Në xhepat e viktimës mund të gjesh ndoshta vetëm qindarka, ndërsa në rast se në internet “godet në shenjë”, mund të përftohesh shifra me shumë zero mbrapa, mbase edhe në një natë të vetme.

### Më shumë vëmendje informacioneve personale

Përdorimi i kompjuterit dhe nëpërmjet tij i internetit, shoqërohet edhe me efekt njerëzor psikologjik disi të veçantë. Ndërkohë që kërkon në adresa të ndryshme në internet, për të arritur apo gjetur atë që kërkon, të duket vetja si në një vend virtual, i ndryshëm nga realiteti i përditshëm, i cili nuk i përkejt askujt dhe gjithçka që ti kërkon është gati të të jepet.

Gjatë këtij lundrimi në internet, të gjithë janë të lirë dhe “anonimë” dhe duket se askush nuk përgjigjet për pasojat e veprimeve që kryen.

Benjamin Franklin (1706 - 1790, poliedrit, shkencëtar dhe politikan amerikan) e kishte parashikuar saktë të ardhmen e kujdesit mbi informacionin kur shprehej se “duhet t’i kushtojmë shumë vëmendje veçanërisht informacioneve personale”. Zhvillimi i teknologjive të reja që ndihmojnë dhe përmirësojnë komunikimin, shoqërohet me përdorimin e tyre nga mashtues dhe grabitës të tipit “phisher” dhe “visher”, të cilët në rast se penetrojnë në banka, kompani dhe ndërmarrje të mëdha, krijojnë probleme ekonomike të ndryshme në nivele edhe më të larta se ato brenda kompanisë. Me zhvillimin e teknologjisë, ndryshojnë, përsosen dhe përshtaten edhe taktikat mashtuese.

Pavarësisht nga këto, duhet kuptuar se aplikimet e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit japin një shtysë shumë të rëndësishme në zhvillimin e një vendi. Fenomenet negative kriminale, shoqëruar me tendencat për grabitje nëpërmjet rrjeteve informatike nuk mund të zbehin apo frenojnë vlerat e pallogaritshme që përftohen nëpërmjet zhvillimeve informatike.

Të mendosh se nuk duhen përdorur teknologji të avancuara se mund të jesh i rrezikuar, ky është një gabim. Për të qenë i sigurt në rrjetet informatike duhet shpenzuar për masat mbrojtëse si dhe për rritjen e njohurive në këtë fushë.

Për ta mbyllur, le t’i drejtohem edhe një herë Benjamin Franklin i cili pohonte se; “Të shpenzosh diçka shpejt është më mirë se të shpenzosh shumë më vonë. Të kesh një mbrojtje gratis është e mrekullueshme, ndërsa të kesh një mbrojtje efikase është akoma më shumë”.

## BËHU I ZGJUAR KUR PËRDOR KARTËN TËNDE

### Këshilla për të parandaluar mashtrimin me karta



#### Karta dhe PIN-i

- Mbroni kartat tuaja dhe numrin personal të identifikimit (PIN) në çdo kohë;
- Nënshkruani shiritin e nënshkrimit në pjesën e mbrapme të kartës që në momentin që e merrni atë;
- Mbuloni me dorë tastierën kur shtypni kodin PIN dhe sigurohuni që askush nuk është duke ju parë;
- Asnjëherë mos mbani kartën tuaj dhe PIN-in së bashku;

#### Ambienti përçark ATM-së!

- Tregohu i vëmendshëm për ndonjë dëmtim apo instalim të pajisjeve të dukshme që nuk është i zakonshëm. Njoftoni menjëherë bankën tuaj;
- Nëse ju mendoni që karta juaj është komprometuar, përdorni një ATM tjetër, ndryshoni PIN-in tuaj dhe raportoni sa më shpejt të jetë e mundur;
- Nëse ATM-ja nuk nxjerr para apo nuk ju kthen kartën tuaj, raportoni menjëherë në bankën tuaj;

#### Blerje në internet!

- Mos e përdorni kodin tuaj PIN kur bëni blerje on-line, nuk është e nevojshme!
- Përdorni një lidhje interneti të sigurt për të bërë blerjen tuaj on-line. Përdori faqet e internetit të cilat fillojnë me HTTPS vend të HTTP;
- Sigurohuni që të përdorni fjalëkalim i cili nuk përfshin të dhënat tuaja personale ( ditëlindjen numrin e telefonit, adresën);

## Në numrin e ardhshëm do të lexoni:

### Parandalimi dhe kontrolli i mashtimeve në industrinë e kartave

Nga Enkelejda Balliu,  
Kryetare e Komitetit të AAB-së kundër Mashtimeve me Karta



OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE  
NË TREGUN BANKAR!



**CBA JU OFRON:**

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, tranferta parash, garanci bankare,  
shkembime dhe te gjitha sherbimet tradicionale bankare

Adresa: Rr."Perlat Rexhepi" ,  
Ndërtesa Administrative "AL-KHARAFI" (prane Fakultetit  
Juridik), Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 2 272168/66; Fax: + 355 4 2 272162  
E-mail: creditbkalb@icc-al.org  
creditcba@icc-al.org

SheratonTirana Hotel  
Shopping Plaza  
Tel: +355 4 2 2255372/388/368/346  
Fax: +355 4 2 255340

Hotel "Butrinti", Sarande  
Tel: +355 85 2254 05



# SIGURIMI I DEPOZITAVE, midis stabilitetit financiar dhe mbrojtjes së kursimtarëve

Intervistë e z. Skënder Emini dhe z. Plator Ulqinaku, dhënë revistës “Bankieri”

Ka ardhur koha që rregullatori të konsiderojë shënjestrimin e një niveli të dëshiruar për fondin e sigurimit, nivel i cili do të diktonte më pas edhe normën e një primi më objektiv sigurimi si dhe frekuencën e pagesës së tij, kjo sidomos në kontekstin e një sistemi bankar likuid dhe të mirëkapitalizuar



*Skënder Emini,  
Drejtore i Divizionit të Kontrollit Financiar,  
Planifikimit dhe Raportimit, BKT*



*Plator Ulqinaku,  
Shef i Departamentit të Menaxhimit të  
Riskut, Union Bank*

**Skënder Emini:** Qëllimi i krijimit të mekanizmit të sigurimit të depozitave kryesisht ka të bëjë me ruajtjen e stabilitetit financiar të një vendi dhe me mbrojtjen e kursimtarëve relativisht të vegjël nga humbja e mundshme që shkaktohet nga falimentimi i një banke. Si rrjedhojë, në përgjithësi, projektimi që bëhet për masën e fondit të sigurimit të depozitave është i tillë që të sigurojë shumicën e depozituesve të një banke që falimenton, por jo të gjithë sistemit.

Një sistem sigurimi i depozitave nuk mund të përballojë i vetëm falimentime të bankave të rëndësishme ose thënë ndryshe një krize sistematike. Kjo gjë është vënë re edhe në krizën më të fundit globale, sidomos në SHBA, ku norma e fondit rezervë rezultoi negative në mes të vitit 2009, për shkak të numrit të shumtë të bankave ose institucioneve të tjera financiare që falimentuan. Në këtë rast, duhet të përfshihen patjetër pjesëmarrës të tjerë të sistemit financiar dhe mekanizma qeverisës që mundësojnë minimizimin e efekteve të këtyre falimentimeve.

Praktika aktuale botërore, ashtu edhe ajo shqiptare, në përgjithësi përpunon t'atë përcaktojë madhësinë optimale të fondit në raport direkt me mesataren e depozitave të siguruar dhe jo me aktivet e bankave, por kohët e fundit, për shkak të krizës financiare, vende të ndryshme po

PYETJE- TEORIKISHT NJË FOND PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE DUHET TË JETË I MJAFTUESHËM PËR TË SIGURUAR ZVOGËLIMIN E PROBABILITETIT TË PAAFTËSISË PAGUESE TË BANKAVE DERI NË NJË MINIMUM TË PRANUESHËM. SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILI DO TË ISHTE RAPORTI MË I MIRË MES AKTIVEVE TË BANKAVE DHE MASËS SË FONDIT TË ASD? E THËNË MË THJESHT, SI MUND TË PËRCAKTOHEJ MADHËSIA OPTIMALE E FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE DHE SI PARAQITET KJO ÇËSHTJE NË RASTIN SHQIPTAR?

**Plator Ulqinaku:** Kjo nuk është pyetje e lehtë për t'iu përgjigjur për arsye se nuk ekzistojnë standarte të mirëfillta. Nuk duhet të harrojmë se praktika e sigurimit të depozitave të klientëve është relativisht e re në teorinë e biznesit dhe atë ekonomike. Për herë të parë këtë praktikë e hasim në Shtetet e Bashkuara kur në 1933 ata ngritën një skemë formale të sigurimit të depozitave si pasojë e krizës bankare të njohur si Depresioni i Madh. Pas 34 vitesh, në 1967, do të ishte Kanadaja ajo që do të ndiqte shembullin e Shteteve të Bashkuara, ndërkohë që në Bashkimin Evropian skemat e sigurimit të depozitave u sanksionuan në 30 Maj 1994 me anë të dekretit 94/19/EC të Parlamentit dhe Komisionit Evropian. Kjo direktivë i kërkonte shteteve anëtare që asokohe të siguronin jo më pak se 90% të depozitave të publikut për një shumë mesatarisht 20'000 EUR.

Misioni i përgjigjes së kësaj pyetje bëhet edhe më i vështirë sidomos në kontekstin Shqipërisë, ku fatmirësisht nuk ekziston një historik i mirëfilltë i falimentimit të bankave tregtare, të paktën jo pasi që skema e sigurimit të depozitave ka qenë aktive. Duke pohuar këtë, kemi njëkohësisht pranuar edhe faktin se fondi i sigurimit të depozitave pranë ASD-së është ende i ri dhe në krijim e

diskutojnë mundësinë e përcaktimit të tij në raport me GDP-në. Sipas informacionit që kam, ky raport në vende të tjera mesatarisht është rreth 2%-3% e depozitave të siguruar ose e totalit të depozitave në të gjithë sistemin e atij vendi, ndërsa në Shqipëri synohet një raport minimal prej 5% ndaj depozitave të siguruar. Edhe në Kosovë, ligji për sigurimin e depozitave që ka hyrë në fuqi së fundmi, parashikon të njëjtën normë-5%.

Sipas raportit vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) ky raport në fund të vitit 2010 arriti në nivelin 2.2%. Mendoj se aktualisht kjo është një praktikë e drejtë dhe duke ju referuar madhësisë së fondit aktual dhe atij të synuar mund të vërehet një normë mbulimi e kënaqshme e depozitave të siguruar për një numër të konsiderueshëm bankash në vend.



**Skënder Emiri** - Në Shqipëri, Ligji Nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për Sigurimin e Depozitave" parashikon sistemin e primit të sheshtë (flat fee premium) në nivelin 0.5% për çdo bankë (e cila mund të lëvizë brenda intervalit 0.1%-0.7%), ndërkohë që kjo normë në vende të tjera me një mesatare të përgjithshme mund të variojë nga 0.15%-0.35% në varësi të sistemit të primit që zbatohet. Por, siç ka vende me norma më të ulëta ka edhe vende me norma më të larta të primit se kjo në vendin tonë. Kështu, sipas sistemit të sigurimit të depozitave të sapo prezantuar në Kosovë, norma e primit është akoma edhe më e lartë, ajo varion nga 0.3%-1.5% në bazë të klasifikimit të riskut/notës së ekzaminimit që bankat marrin nga Banka Qendrore e Kosovës. Kjo mendoj për faktin se vendet pak të zhvilluara ose në zhvillim paraqesin rreziqe më të larta në këtë aspekt dhe burimet alternative financiare për siguresit janë më të kufizuara.

Në rastin e Shqipërisë, siç dihet, ndryshimet ligjore të bëra në mars 2009 (ligji nr. 10106), të cilat hynë në fuqi në vitin 2010, rritën shumën e siguruar të depozitave nga 700,000 Lek në 2,500,000 Lek, por pa ndryshuar nivelin e primit, pra duke rritur ndjeshëm me afro 82% edhe koston vjetore të sistemit bankar në lidhje me primin e sigurimit të depozitave paguar ndaj ASD-se në vitin 2010.

Sipas raportit të ASD-së, primi vjetor i arkëtuar nga

sipër. Kështu, deri në fund të vitit 2010, periudhë për të cilën kemi të dhëna të disponueshme, fondi i sigurimit i akumuluar pranë ASD-së është 0.8% i totalit të mjeteve të sistemit bankar, ose 1.1% e depozitave të individëve në sistem, depozitat e të cilëve deri në shumën 2.5 milion lekë janë të sigurueshme.

Po të hedhim një vështrim në rajon dhe më gjerë do të shohim se vende si Bullgaria, për shembull, kanë një nivel shënjestër për fondin që ky të arrijë 5% të bazës së depozitave të sigurueshme. Me strukturën aktuale "depozita të individëve kundrejt totalit të mjeteve" që ka sistemi bankar shqiptar, ky nivel shënjestër për fondin do të përkthehej në 3.49% të totalit të mjeteve.

Shtetet e Bashkuara ndërkohë, si vendi me praktikën më të stabilizuar të sigurimit të depozitave, e kanë nivelin shënjestër 1.35% të depozitave të siguruar duke mos lejuar që fondi të zbrësë poshtë këtij niveli. Sërish në kuadrin e strukturës së depozitave në sistemin Shqiptar bankar, niveli Amerikan do të përkthehej në 0.94% të totalit të mjeteve të këtij sistemi. Siç edhe shihet qartë, fondi Shqiptar është ende larg niveleve qoftë edhe ato minimale të ngjashme me Shtetet e Bashkuara gjë që flet për nevojën që ka ky fond për të akumuluar ende mjete. Ndoshta ka ardhur koha që rregullatori të konsiderojë shënjestrimin e një niveli të dëshiruar për fondin e sigurimit, nivel i cili do të diktonte më pas edhe normën e një primi më objektiv sigurimi si dhe frekuencën e pagesës së tij, kjo sidomos në kontekstin e një sistemi bankar likuid dhe të mirë-kapitalizuar.

**PYETJE- NORMA E PRIMIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE NË SHQIPËRI ËSHTË MË E LARTA KRAHASUAR ME RAJONIN DHE ME SHUMË VENDE NË BOTË. PSE NDDODH KJO? ÇFARË MUND TË PROPOZOHEJ SI DHE CILAT JANË RRUGËT E ARRITJES SË NJË STADI TË RI MES ASD DHE BANKAVE TREGTARE? SI PARAQITET TOTALI I PRIMIT TË PAGUAR NGA SISTEMI NË RAPORT ME TOTALIN E FITIMIT QË SISTEMI BANKAR GJENEROI GJATË VITIT TË KALUAR OSE ME TOTALIN E SHPENZIMEVE QË SISTEMI BANKAR KA KRYER GJATË VITIT TË KALUAR?**

**Plator Ulqinaku:** Vendet në rajon aplikojnë një varietet skemash që e bëjnë të vështirë krahasimin. Bosnja, për shembull, është një vend që ashtu si Shqipëria siguron vetëm depozitat e individëve, ndërkohë që Bullgaria siguron 100% depozitat e individëve dhe 50% ato të bizneseve. Serbia dhe Rumania synojnë sigurimin e depozitave të individëve dhe kompanive. Normat e primit të sigurimit për këto vende variojnë nga 0.3% e depozitave të sigurueshme në Bosnjë deri në 0.8% në Rumanë; kjo e fundit e llogarit primin mbi balancën e depozitave më 31 Dhjetor të çdo viti. Serbia e llogarit primin 0.1% çdo tremujor (pra 0.4% në vit) ndërsa Bullgaria mbi mesataren ditore përgjatë vitit në një nivel 0.5% të depozitave të sigurueshme.

Pra, siç edhe përmenda më sipër, krahasimi është më të vërtetë i vështirë. Por përtej lojës së krahasimit, unë mendoj se në përgjigjen e pyetjes tuaj ne duhet të mbajmë në konsideratë karkarakteristikat e sistemit bankar Shqiptar si dhe impaktin e këtij primi në biznesin e bankave që operojnë në Shqipëri.

Kështu, është shumë e rëndësishme të kuptohet se sistemi bankar Shqiptar është mjaftueshëm likuid. Në fund të vitit 2010, kreditë, si kategoria më me risk e mjeteve, përfaqësojnë vetëm 47.5% të totalit të mjeteve në sistemin bankar. Pjesa tjetër e mjeteve është e investuar në letra me

## Skemë alternative: Sa? Si? Pse?

bankat për vitin 2010 ishte 1,941 milionë Lek, i cili përbën rreth 8.5% të totalit të shpenzimeve të veprimtarisë të sistemit bankar.

Ky raport është shumë herë më i madh përkundrejt fitimit (afërsisht 30%), nëse do të kishim parasysh që fitimi neto i sistemit bankar gjatë vitit 2010 ishte vetëm 6.7 miliardë Lek.

vlerë të Qeverisë Shqiptare (rreth 33.4%) dhe vendosje bankare me bankat e tjera dhe Bankën e Shqipërisë (11.5%), si dhe para fizike dhe mjete fikse, të cilat të gjitha së bashku përmbajnë risk minimal për sistemin.

Për më tepër, raporti "kredi/ depozita" është shumë poshtë nivelit 100% (57.1% në fund të vitit) duke dëshmuar se sistemi bankar ka kapacitete mëse të mjaftueshme për t'u rritur në kreditim, pa qenë nevoja të mbështetet në mënyrë të tepruar në financime të jashtme. Prandaj, duke qenë se sistemi bankar Shqiptar është mjaftueshëm likuid, mund të deduktohet se bankat kanë mjete mëse të mjaftueshme likuide për të shlyer gjithë depozitat e siguruara. Këtu nuk duhet të harrojmë se risku i ASD-së zbehet kur bankat shlyejnë në mënyrë rutinore depozitat e siguruara, sepse mjetet likuide zvogëlojnë detyrimin potencial të ASD-së, duke e bërë këtë të fundit madje të mbikapitalizuar. Sistemi bankar Shqiptar nga ana tjetër është i mirëkapitalizuar gjë që e bën atë të aftë të përballojë dhe absorbojë humbje të mundshme nga aktiviteti, pa qenë nevoja të likuidojë mjetet e veta. Dhe këtu sërish risku i ASD-së zbehet.

Një tjetër aspekt, i cili nuk duhet anashkaluar, është kostoja e sigurimit që ka një impakt negativ në rezultatet e bankave të cilat, në një përpjekje për të ruajtur marzhet e tyre, synojnë që t'i transferojnë kostot e shtuara tek klientët duke ulur interesat e depozitave. Është mëse e vërtetë se interesat e depozitave duhet të reflektojnë kostot e fondeve bazuar në mekanizmat e tregut. Por nuk duhet harruar se një ulje e tyre përtej këtyre mekanizmave thjesht për të absorbuar primet e tepërta të sigurimit, i bën bankat më pak tërheqëse ndaj klientëve të tyre me një impakt hipotetik rënien e vëllimit të depozitave. Skenari i fundit nuk është më i miri as për ASD-në e cila do të përfitonte më pak të ardhura nga primet e sigurimit të cilat natyrisht shkojnë në përpjestim të drejtë me vëllimin e depozitave. Për këtë arsye është e rëndësishme që primi i sigurimit dhe kostot e lidhura me to të qëllorjnë një balancë të shëndetshme mes efekteve pozitive në publik, që e bën këtë të besojë dhe të depozitojë në sistemin bankar, dhe zhvillimit të biznesit dhe rritjes së tij i cili do të lejonte absorbimin e kostove pa ndërhyrë në mënyrë të sforcuar në mekanizmat e tregut.

vijon në fq. 25 ►►





# Emporiki Bank

CRÉDIT AGRICOLE GROUP

**Anëtare e Grupit më të Madh Bankar në Francë**



► fillimi në fq. 23

**Skënder Emini** - Po, aktualisht ka shumë diskutime për dy skemat e sigurimit të depozitave në lidhje me normën e primit. Në Shqipëri, por jo vetëm, zbatohet norma e sheshtë e primit për të gjitha bankat. Ndërsa, shumë vende të tjera, ku përfshihen edhe vende të zhvilluara ose vende me një infrastrukturë të konsoliduar të sistemit financiar (SHBA, Kanada, Turqi etj.), zbatojnë sistemin e primit të diferencuar mbi bazën e rrezikut individual të vlerësuar për cdo bankë.

BKT, gjatë takimeve të ndryshme të bëra me përfaqësues të ASD-se dhe BSH-së ka shprehur qartazi opinionin e saj për ndryshimin e sistemit aktual të primit nga ai i sheshtë në atë të diferencuar. Kjo për faktin se një sistem i diferencuar i primit në bazë rreziku është në përputhje edhe me teorinë e përgjithshme të sigurimeve, që merr në konsideratë jo vetëm dëmin potencial, por edhe rrezikun e ndodhjes së tij. Gjithashtu, një sistem i tillë jo vetëm që do të ishte më i drejtë (fair premium), duke "penalizuar" bankat që mbartin më tepër rrezik në aktivitetin e tyre, por në të njëjtën kohë do t'i orientonte bankat në kryerjen e veprimtarive me pak të rrezikshme, duke përmirësuar kështu edhe sistemet e tyre të menaxhimit të rrezikut. Sistemet e primit të sheshtë, përkundrejt problemeve të nënkuptuara më lart, kanë thjesht avantazhin e të qenit relativisht më të lehta për t'u kuptuar dhe administruar.

Aspektet më të vështira, që diskutohen nga ekspertë të ndryshëm, për zbatimin në praktikë të metodës së primit të diferencuar kanë të bëjnë kryesisht me gjetjen e metodave të duhura për klasifikimin e nivelit të rrezikut të çdo banke, kategorive të ndryshme të rrezikut dhe normës së primit për çdo kategori. Në këtë kuadër, sugjerohet që normat e ndryshme të primit duhet të jenë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e shkallës së financimit të kërkuar nga siguruesit dhe të inkurajojnë efektivisht një menaxhim të shëndetshëm të rrezikut bankar.

Në përfundim, me këtë rast, BKT do të dëshironte të risillte në vëmendjen e autoriteteve përkatëse shqiptare alternativën e sistemit të primit të diferencuar sipas rrezikut, ku si bazë klasifikimi për rrezikun e bankave mund të përdoret nota e ekzaminimit e Bankës së Shqipërisë për çdo bankë të vlerësuar sipas sistemit CAMELS, praktikë kjo e zbatuar së fundmi edhe në Kosovë. Në këtë pikë, normat e ndryshme të primit për kategoritë e vecanta të klasifikimit të rrezikut mund të jenë të tilla që të mos ndikojnë në një rënie të mundshme të shumës totale të primit që arkëtohet aktualisht nga ASD.

PYETJE - EKSPERTËT NË DISKUTIMET E TYRE TEKNIKE NDAJNË MENDIME TË NDRYSHME PËR DY SKEMA TË DISKUTUARA PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE: E PARA ËSHTË NORMA E SHESHTË E PRIMIT DHE, E DYTA ËSHTË PRIMI I BAZUAR MBI RISK. CILA ËSHTË SIPAS JUSH SKEMA MË E VLEFSHME PËR SISTEMIN TONË, PO TË BËHEJ FJALË PËR NDRYSHIMIN E FONDIT TË BANKAVE PËR EFEKT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË KLIENTËVE. PSE DUHET TË JETË AJO, CILAT JANË AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E SKEMËS SË ZGJEDHUR.



**Plator Ullqinaku:** Edhe pse primi i bazuar mbi risk ngjan se ka mjaft përparësi, gjithmonë duke supozuar se ai zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të duhur dhe bazuar në indikatorë objektivist të matshëm, një pjesë e mirë e bankave në Shqipëri janë në favor të primit të sheshtë. Le të sqarojmë si më poshtë:

Përparësia kryesore e primit të bazuar mbi risk është se ai lejon axhustimin e primit në nivele realiste në varësi të riskut – bankat më me risk paguajnë më shumë prim, dhe ato me më pak risk prime më të ulta.

Në këtë mënyrë bankat do të kishin një nxitje instinktive për të bërë një menaxhim sa më të mirë të riskut në mënyrë që të shmangin pagesat e tepërta dhe të panevojshme të primit të sigurimit.

Por disavantazhi më i madh i primit të bazuar në risk është se mund të lërë shteg për gjykime subjektive.

Kështu bankat e vogla do të rëndoheshin me pesha më të mëdha

risku sesa bankat e mëdha duke u ndikuar më tepër nga shpenzimet për primin e sigurimit dhe duke u gjendur në disavantazhe konkurrese jo për arsye që lidhen me biznesin e tyre, dhe aq më pak me profilin e tyre real të riskut, i cili jo domosdoshmërisht lidhet me madhësinë e bankave.

Pra, shqetësimi është se trajtimi i bankave në baza të ndryshme mund të rezultojë me fitime ose humbje relative sidomos karshi bankave të kategorisë së kundërt të riskut. Për më tepër ekziston rreziku që perceptimi i publikut të mund të ndikohet në mënyrë të gabuar për një bankë të caktuar thjesht nisur nga lloji i primit të bazuar në risk duke e thelluar edhe më disavantazhin konkurrues të asaj banke.

Për këtë arsye mendoj se në mënyrë që të shmangen ndërlikimet e primit të bazuar në risk, ndoshta është më e udhës që të ruhet aplikimi i primit të sheshtë për të gjitha bankat. Një prim i tillë do të ishte më i lehtë për t'u kuptuar dhe zbatuar si nga rregullatori ashtu edhe sistemi bankar, dhe ç'është më e rëndësishmja do të ishte neutral për perceptimin e publikut.

Intervistoi: B. Sejdarasi



# EFIÇENCA E ENERGJISË

Objektivi i Shqipërisë për t'u bërë një ekonomi tregu plotësisht konkurruese vazhdon të pengohet nga pasiguria lindur nga problemet e furnizimit me energji. Mungesat e shpeshta të energjisë kanë efekt negativ në produktivitetin e sektorit privat dhe aktivitetit të investimit dhe zhvillimi i ekonomisë Shqiptare do stepet derisa të zgjidhet çështja e furnizimit të qëndrueshëm me energji. Zgjidhja mund të jetë vetëm në dy drejtime: a) të rritet sasia e energjisë që furnizon tregun nëpërmjet energjisë së rinovueshme dhe b) të rritet përdorimi eficient i energjisë. Përfshirja e institucioneve financiare në



projekte kreditimi për eficientë e energjisë rrit impaktin e kursimit të energjisë nëpërmjet individëve. Bankat tregtare janë të orientuara drejt zhvillimit nëpërmjet një shërbimi të përgjegjshëm. Pjesë e kësaj përgjegjësie është edhe obligimi për të vepruar në përputhje me standardet sociale, etike dhe ambientale. Sot e vetmja rrugë e mundshme për të ulur kostot e energjisë elektrike, për të mbrojtur mjedisin si dhe për të shfrytëzuar sa më mirë burimet natyrore është pa dyshim EFIÇENCA E ENERGJISË.

## Dy banka në sistem krijojnë produkte për promovimin e EFIÇENCËS SË ENERGJISË



ProCredit Bank

ProCredit Bank është banka e parë në Shqipëri që i dha rëndësi të veçantë përdorimit efikas të energjisë, duke ofruar një produkt të dedikuar. Kredia "Eficiencia e Energjisë" është financimi i investimeve në ambientet e biznesit dhe në banesa të cilat sjellin përdorim eficient të energjisë dhe kursimin e saj.

Prezantimi i këtij produkti të ri u mundësua nëpërmjet bashkëpunimit të ProCredit Bank Shqipëri me Fondin Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) dhe KfW, kompani të mirënjohura në mbarë botën për mbështetjen e ekonomive në vendet në zhvillim.

Kredia për përdorimin me eficiencë të energjisë ndihmon familjet dhe bizneset në uljen e kostove të energjisë dhe ndikon në përmirësimin e standardeve të jetesës së individëve. Bizneset kanë mundësinë e uljes së shpenzimeve mujore, pasi duke ulur konsumin e energjisë reduktohet faktura e energjisë elektrike. Një përfitim tjetër mjaft i rëndësishëm për bizneset është



sigurimi i avantazhit konkurrues në treg.

Banka ka një trend gjithnjë në rritje të portofolit të kredive Eficiencia e Energjisë. Që nga nxjerrja e këtij produkti në korrik të vitit 2009 është krijuar një portofol mbi 6 milionë Euro dhe është vënë re një interes nga ana e klientëve në rritje, pasi energjia është një çështje që i prek të gjithë.

Me mbështetjen e IPC (International Project Consultant - një prej aksionerëve më të mëdhenj të ProCredit Holding dhe një kompani

e mirënjohur ndërkombëtare në ofrimin e konsulencës për projekte të zhvillimit të ekonomive), ProCredit Bank zotëron një teknologji të avancuar llogaritje të kursimit të energjisë për sektorët më potencialë të biznesit në Shqipëri, nëse investojnë në produkte efikase. P.sh. nëse një klient ka si aktivitet pastičeri dhe investon në një furrë të re pjekje me kapacitet 30 kwh dhe orë e punës që planifikohet të përdoret janë diku te 10 orë, atëherë kursimi vjetor i energjisë elektrike do të jetë me përafërsi rreth 460 000 Lekë. Këshilluesit e biznesit përveç këshillimit financiar ofrojnë dhe këshillim teknik për sa i përket investimit në produktet efikase të energjisë. ProCredit Bank ka dhënë edhe shembullin e vet në drejtim të adoptimit të metodave për kursimin e energjisë duke investuar në Degën e Gjellbër të Laprakës. Me këtë, e masa të tjera ProCredit Bank konfirmon angazhimin e saj ndaj një përfaqse që respekton mjedisin dhe përmirëson jetesën e individëve.

Credins bank është angazhuar seriozisht në iniciativën e ndërmarrë nga IFC, për promovimin e masave që bëjnë të mundur kursimin e energjisë. Më konkretisht në shkurt të vitit 2010 Credins Bank dhe IFC nënshkruan një marrëveshje, për financimin nga Credins të kredive “Eficenca e Energjisë”. Obligimi social për të qenë pjesë e promovimit të kursimit të energjisë elektrike, bëri që Drejtuesit e bankës të jepnin aprovimin e tyre për hedhjen në treg të një produkti i cili ti dedikohet totalisht kursimit të energjisë elektrike. Nëpërmjet kredisë “Kursimi i energjisë”, klienti financohet deri në 10.000.000 lekë, me një afat maksimal 7 vjet. Nëse deri në shkurt të vitit 2010, Credins Bank financonte klientët e saj nëpërmjet kredive të thjeshta për rikonstruksion ambientesh banimi, sot ajo ofron një informacion më të detajuar në lidhje me metodat dhe pajisjet për kursimin e energjisë. Klientit i jepet një informacion i saktë për sasinë dhe vlerën monetare që



mund të kursejnë nëse realizojnë një investim që ka për bazë përdorimin e metodave të kursimit të energjisë, që mundësohet nga një Tool i përgatitur nga IFC. Konkretisht, kur klienti paraqitet në bankë për t'u financuar me një kredi për rikonstruksion banese, atij i shpjegohen të gjithë masat që mund të ndërmarrë me qëllim rritjen e efikasitetit të energjisë në banesën e tij. Për çdo investim që ai do të ndërmarrë klientit i

përlllogaritet kursimi në faturën e energjisë elektrike; dhe i vihet në dispozicion një listë e shoqërive të cilat ofrojnë pajisje që sigurojnë kursimin e energjisë elektrike. Gjatë periudhës 18 mujore, portofoli i kredisë “Kursimi i energjisë” ka arritur në 1 milion EURO, dhe një numër total prej 240 kredi. Nga një studim që i është bërë kohët e fundit këtij portofoli është parë se pjesa më e madhe e investimeve të realizuara nga klientët është në: a) blerje dyer dritare dopio xham, b) blerje të pajisjeve elektroshtëpiake eficiente, c) ndriçim eficient dhe d) blerje të pajisjeve që sigurojnë mbrojtjen nga rrezatimi diellor (tenda, grila).

Fokusi i Credins Bank në të ardhmen do të jetë shtrirja e financimit me qëllim kursimin e energjisë edhe në fushën e biznesit. Po kështu, do të vazhdojnë fushatat promovionale me qëllim sensibilizimin e shoqërisë në lidhje me përfitimet nga përdorimi i metodave të kursimit të energjisë, dhe përfitimet që ka mjedisi në të cilin jetojmë.

## Eficienta e Energjisë dhe SISTEMI BANKAR

Shoqata Shqiptare e Bankave, duke ndjekur zhvillimet pozitive në tregun e Eficencës së Energjisë, është angazhuar për ta bërë pjesë të këtij tregu bankat anëtare. AAB ka mbështetur, marrë pjesë dhe bashkëpunuar në organizimin e veprimtarive për prezantimin e mekanizmave financiarë për promovimin e Eficencës së Energjisë dhe gjetjen e mënyrave të përbashkëta të bashkëpunimit. Ndër to:

- Në Qershor 2011 IFC në bashkëpunim me AKBN organizoi seminarin “Mbi efikasitetin e energjisë në banesa”, ku morën pjesë përfaqësues të Bankave dhe AAB-së, përfaqësues të Projektit të IFC-se, KFW, GIZ, UNDP, dhe AKBN.
- Në Korrik 2011, AAB organizoi në ambientet e saj në bashkëpunim me Programin Shqiptar për Transformimin e Tregut për Përdorimin e Paneleve Diellore për Ujë të Ngrohtë, të UNDP, tryezën e rrumbullakët ku u prezantuan disa konkluzione lidhur me fizibilitetin e mekanizmave financiarë për promovimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë.

Ajo çfarë del qartë nga diskutimet në të tilla tryeza është nevoja për krijimin e një tregu të ri dhe një mjedisi të favorshëm bashkëpunimi dhe garantimi nga ana e Qeverisë Shqiptare apo donatorëve të skemave të subvencionimit për mekanizmat e nevojshëm financiarë për mbështetjen e Eficencës së Energjisë.





Nga Lindita Varesi  
MBA & PhD Candidate  
Finance & Banking  
SBB Credit Risk Supervisor,  
NBG Bank

## Dërgesat nga emigrantët, DEPOZITAT dhe BANKAT

Bankat duhet të shikojnë bizneset e vogla me më shumë pasion, të dëgjojnë kërkesat e tyre dhe të ndryshojnë mënyrën e trajtimit të tyre; të rishikojnë politikatat e financimit të tyre

**B**ankat në Shqipëri janë fokusuar kryesisht në rritjen e depozitave si burim kryesor financimi në këtë sektor. Financimet e huaja në industrinë bankare janë të kufizuara dhe bankat vetë investojnë kryesisht në kredi dhe në banka të tjera në vend.

Kjo është edhe arsyeja që politikatat dhe strategjitë e hartuara insistojnë në shtimin e sasisë së depozitave, veçanërisht në këtë vit të vështirë ekonomik për vendet fqinje.

Rritja e depozitave është e lidhur drejtpërdrejtë me nivelin e kursimit, konsumit dhe atë të të ardhurave.

Të ardhurat nga ana e tyre mund të rriten si rezultat i rritjes së pagave të individëve, të fitimeve (në rastet e bizneseve) dhe i rritjes së remitancave. Konsumi rezulton të jetë rritur me 1.6% në simestrin e parë të vitit 2010

57% e familjeve që marrin dërgesa nga jashtë e përdorin të gjithë shumën e dërguar dhe nuk kursejnë. Pjesa tjetër, pra rreth 43% e përfituesve përdorin për ushqim/konsum deri në masën 65% të të ardhurave dhe diferenca kursehet ose investohet. Vetëm 6% e kursenin të gjithë shumën.

dhe 0.9% në gjashtëmujorin e dytë të 2010. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së pagave sepse burimet e tjera financuese dhe remitancat kanë qenë në nivele të ulëta.

Gjatë muajve qershor - gusht është folur shumë për një rënie të remitancave në vend. Disa banka që operojnë në Shqipëri e lidhin rënien e nivelit të depozitave të tyre me rënien e remitancave.

Mirë është të gjenden shkaqet apo arsyet konkrete të kësaj rënieje.

Remitancat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave të individit dhe në stimulimin e bizneseve, kryesisht ato të vogla, por nuk mund të konsiderohen si kusht i mjaftueshëm për rritjen e depozitave.

Gjatë viteve 2004 - 2008 remitancat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e industrisë bankare.

Gjatë vitit 2009 remitancat shënuan rënie me 6% krahasuar me vitin 2008, ndërsa gjatë vitit 2010 ranë me 11.7% krahasuar me vitin 2009.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 rënia e tyre ka qenë në masën 12% dhe krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2009 kanë rënë me 19%.

Mirëpo nuk mund të themi të njëjtën gjë për depozitat. Rënia e remitancave nuk është shoqëruar me një rënie të depozitave, madje ritmet e rritjes së tyre kanë qenë të larta.

Në bazë të të dhënave të Bankës së Shqipërisë në vitin 2010 totali i depozitave ka qenë 816.7 (miliard ALL) kundrejt 694.3 (miliard ALL) në fund të vitit 2009.

Depozitat u rritën mesatarisht gjatë vitit 2010 me 15.5% ndërsa në dhjetor me 18.5% duke shënuar kështu rritjen më të lartë. Fluksi më i madh i hyrjeve natyrisht ka qenë periudha qershor - shtator. Depozitat me afat përbënin 78.6% të totalit të depozitave kundrejt 77.2% në fund të vitit 2009.

Pra më e rëndësishme se sasia e remitancave është fakti se si ato përdoren nga “përfituesit”.



Sipas të dhënave të një studimi të bërë nga Instituti Agenda, "Efektet e rënies së Remitancave në Shqipëri", 57% e familjeve që marrin dërgesa nga jashtë e përdorin të gjithë shumën e dërguar dhe nuk kursejnë. Pjesa tjetër, pra rreth 43% e përfituesve përdorin për ushqim/konsum deri në masën 65% të të ardhurave dhe diferenca kursehet ose investohet. Vetëm 6% e kursenin të gjithë shumën. Nga pjesa e kursyer, 47% të kësaj shume mbahet në shtëpi dhe nuk depozitohet fare në bankë.

Emigrantët nën situatat ekonomike të krijuara në vendet fqinje kanë vendosur kthimin e tyre në vend dhe startimin e bizneseve të vogla në ato aktivitete që ata kanë fituar eksperiencë dhe që ia lejojnë kursimet e tyre.

Pra, mbështetur në argumentet e mësipërm, rezulton se rritja e nivelit të depozitave ka ardhur kryesisht nga rritja e nivelit të kursimeve nga shqiptarët që jetojnë dhe punojnë brenda vendit. Dërgesat bazuar në shifrat e dhëna rrisin nivelin e jetesës, rrisin konsumin, por jo kursimin në ato nivele që ne mendojmë.

Kriza e vendeve fqinje dhe integrimi i emigrantëve në to ka sjellë tkurrje të dërgesave, por në të njëjtën kohë krijon mundësi të reja për zgjerimin e ekonomisë.

Vetëm në qytetin e Fierit gjatë muajve të parë të vitit janë regjistruar 310 biznese nga të cilat 270 të vogla. Ndoshta bankat duhet të zgjohen dhe të përqendrohen më shumë tek kërkesat e këtyre bizneseve. Bankat duhet të shikojnë bizneset e vogla me më shumë pasion, të dëgjojnë kërkesat e tyre dhe të ndryshojë mënyrën e trajtimit të tyre; të rishikojnë politikat e financimit të tyre. Të përdorin mënyra të ndryshme për qasjeje për bizneset e vogla dhe ato të mesme. Kështu ndihmojnë rritjen e të ardhurave të këtyre bizneseve të vogla dhe në mënyrë indirekte rritjen e depozitave aq shumë të nevojshme si burim kryesor likuiditeti të nevojshëm për financim.

## KONKURS I HAPUR

SAVINGS BANKS  
ACADEMIC AWARD 2012

Submit a study on retail banking!  
Get your study published!  
WIN UP TO €5,000!

1st prize €5,000 2nd prize €2,500 3rd prize €1,500

For more information on the competition  
and how to participate, visit [www.esbg.eu](http://www.esbg.eu)

An initiative of the  
European Savings Banks Group  ESBG

Çmimi është projektuar për çdo punë akademike e cila adreson si evolucionin e bankave të kursimit ashtu edhe kursimin e komunitetit në përgjithësi. Inkurajohen në veçanti ato punime që i dedikohen aspekteve historike të bankave të kursimit.

Fituesit do ti jepet një çmim prej 5.000 Euro, finalistit të vendit të dytë 2.500 Euro dhe finalistit të vendit të tretë 1.500 Euro.

Publikimi i punimit fitues do të publikohet në një nga botimet e mëposhtme në varësi të temës, rëndësisë dhe lexueshmërisë së punimit:

- "Cahiers de l'épargne" of the "Association pour l'histoire des Caisses d'Épargne"
- "Perspectives" of the "European Savings Banks Group"
- "Sparkassen in der Geschichte" of the "Wissenschaftsförderung der Sparkassen-Finanzgruppe"
- "Estudios" de la Fundación de las Cajas de Ahorros Confederadas para la Investigación Económica y Social.

Për të dërguar punimet tuaja dhe për më shumë informacion lidhur me konkursin kontaktoni në adresën [adrianb@bkt.com.al](mailto:adrianb@bkt.com.al)

# Depozita Perfekte



- Interesi 1 vit - **4% EURO.**
- Shton/tërheq në çdo kohë, pa humbur interesin.
- E vlefshme për çdo lloj shume.

Në Depozitën Fibank - Të gjitha së bashku



**Fibank**  
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË  
**0800 01 11**

[www.fibank.al](http://www.fibank.al)



Nga Najada Xhaxha  
Kryetare e Komitetit të AAB-së  
për Sistemet e Pagesave

Sistemi i ri Bankar në Shqipëri ka një histori 20 vjeçare. Pavarësisht luhatjeve gjatë viteve të para, ligje të reja në sistemin bankar gjatë vitit 1998 krijuan mundësi të rëndësishme për zhvillime në biznesin bankar. Banka të reja të huaja janë hapur ndërkohë, ndjekur nga karakteristika të reja, mendësi ndryshe dhe profesionalizëm të lartë, sasi dhe cilësi shërbimesh, duke bërë të mundur thyerjen e një mentaliteti në mënyrën e të berit “banking”

Duke folur për stabilitetin dhe efikasitetin në sektorin financiar dhe ekonominë e vendit, këndvështrimet janë nga më të ndryshmet. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sistemin bankar, i cili është studiuar dhe komentuar në shumë dimensionë, duke dhënë përparësitë dhe zhvillimet e ndodhura, përkrahjen dhe rolin që ka luajtur në vendosjen e përparësive në ekonominë shqiptare. Në këtë artikull do të përqipemi të shohim zhvillimin e sistemeve të pagesave në Shqipëri dhe ndikimin që kanë patur ato si shtylla kryesore e lëvizjes së fondeve monetare brenda vendit.

## Sistemi i pagesave në Shqipëri NJË HISTORI SUKSESI

### Pak histori

*Deri në vitet '90, Banka e Shtetit kryente të gjitha funksionet e mundshme të një sistemi bankar, që nga emisioni i monedhës, kredidhënien afatshkurtër ose afatgjatë, përfitues të të cilave ishin po vetë ndërmarrjet shtetërore, kryente shërbimin e arkës unike, mbante llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetit, ruante fondet në valutë të tij, kryente veprimet ekonomike dhe financiare të shtetit me vendet e tjera. Nuk ekzistonin nocione të produkteve apo shërbimeve për shoqërinë konsumatore, apo të lejoheshin ekonomi private, të vogla ose të mëdha.*

### Zhvillimet në sistemet e pagesave

Me fillesa në një centralizim ekstrem, Sistemi i Ri Bankar në Shqipëri ka një histori 20 vjeçare. Pavarësisht nga luhatjet gjatë viteve të para, ligje të reja në sistemin bankar, gjatë vitit 1998, kanë krijuar mundësi të rëndësishme për zhvillime në biznesin bankar. Banka të reja të huaja janë hapur në këtë periudhë, ndjekur nga karakteristika të reja, mendësi ndryshe dhe profesionalizëm të lartë, sasi dhe cilësi shërbimesh, duke bërë të mundur thyerjen e një mentaliteti në mënyrën e të berit “banking”.

Kjo vlen edhe për pjesën operacionale të funksionimit të bankave, e cila paraqitet nëpërmjet infrastrukturës së sistemeve operacionale, pjesë e të cilave është edhe ajo e pagesave. Nëse bëjmë një krahasim me vendet e tjera, ku sisteme dhjetra vjeçare, të administruara nga Shoqata e Bankierëve apo institucione të tjera vendase, rregullonin funksionimin dhe kryerjen e pagesave lokale, për vendin tonë nuk mund të themi të njëjtën gjë.

Deri në vitin 2000, në Shqipëri nuk ekzistonte një sistem i mirëfillte pagesash. Bankat komunikonin dhe realizonin këtë veprimtari në mënyrë manuale, rregulluar dhe përshtatur nga udhëzime. Viti 2000, së bashku me Euron, do të kërkonte dhe një ristrukturim të përgjithshëm të sistemeve në veprim. Për të paraprirë zhvillimet ekonomike dhe financiare, të kushtëzuara nga kjo monedhë e re, Bankat Qendrore të vendeve të zhvilluara Evropiane, mundësuan krijimin e një sistemi të përbashkët, i cili do të realizonte mirëfunksionimin emarrëdhënies financiare midistyre. TARGET1 është quajtur sistemi i parë evropian, nëpërmjet të cilit Bankat Qendrore kryenin veprimtarinë e tyre monetare. Kjo periudhë përkon me vendimin e Bankës Qendrore në Shqipëri për implementimin e një Sistemi Kombëtar Pagesash. Përshtatur me kohën dhe pa nostalgjinë për një sistem pagesash që nuk ekzistonte, komuniteti bankar në Shqipëri vendosi të ndërtojë një infrastrukturë bazuar në platformën Evropiane, duke e adoptuar atë për

kushtet dhe monedhën vendase. Gjithsesi, mund të thuhet me krenari se Sistemi ynë Kombëtar i Pagesave, implementuar dhe vënë në funksionim në vitin 2003, është një sistem bashkëkohor, kompetitiv dhe i përshtatshëm për të mbështetur Qeverinë dhe Ekonominë Shqiptare në integrimin Evropian. Për kohën, ishte një arritje e suksesshme e sistemit bankar shqiptar, krahasuar kjo me disa vende më të zhvilluara të rajonit.


## **Ekonomia Shqiptare dhe sistemi funksional i pagesave**

Për ekonominë shqiptare është shumë i rëndësishëm promovimi i funksionimit normal të sistemeve të pagesave, ku Banka e Shqipërisë, si menaxhuese e tij, luan një rol administrativ. Në Shqipëri tashmë ekzistojnë dy sisteme pagesash: sistemi qendror AIPS, bazuar në konceptin RTGS (Real-Time-Gross-Settlement) dhe ai komplementar AECH, nëpërmjet të cilave Banka e Shqipërisë ofron kuptimin e shlyerjes neto të pagesave në monedhën lokale. Banka e Shqipërisë përcakton standardet dhe rregullat me qëllim sigurimin e efikasitetit të këtyre sistemeve të pagesave dhe instrumentave të tyre. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë vlerëson sistemet kundrejt këtyre standardeve dhe vepron si katalizator. Këto sisteme janë analoge me ato evropiane dhe operojnë nën teknologjinë dhe rregullsinë e tyre. Kështu, AIPS është i bazuar në parimet RTGS dhe funksionon nën infrastrukturën e saj, duke përbërë një potencial në përshtatshmërinë e saj për pjesëmarrje në TARGET 2. AECH është një sistem komplementar që vepron nën AIPS duke qenë pjesë e rregullave të saj, duke u krahasuar lehtësisht me sistemin Evropian SEPA (Single European Payment Area). Banka Qendrore - Banka e Shqipërisë ka një rol të madh dhe obligim në zhvillimin e sistemeve kombëtare të pagesave.

Në këtë mënyrë Sistemet e pagesave kanë reflektuar efikasitet dhe siguri, ndërkohë që bankat e nivelit të dytë janë lojtarët kryesorë të tyre.


Gjithashtu, pjesë e këtyre sistemeve janë procesimi dhe shlyerja e pagesave të kartave (kredit apo debiti) që operojnë në tregun shqiptar nëpërmjet rrjetit të ATM-ve apo POS-eve, kryerja e transaksioneve të Bonove të thesarit, të Ardhurat e Buxhetit të shtetit, etj.

Grafik 1. Progresi i transaksioneve në AIPS gjatë viteve 2007 - 2010



Sistemit AECH	2007	2008	2009	2010
Numri i transaksioneve	71,857	113,682	102,304	332,777
Vlera e transaksioneve (miliardë Leke)	12.01	17.61	15.46	43.9


Burimi: Banka e Shqipërisë



## **Një projekt i rëndësishëm, përfundon faza e parë**

Le të mbetemi në marrëdhënien e veprimeve të Buxhetit të Shtetit me këto sisteme pagesash. Deri vonë në vitet 2009, veprimet financiare të mbledhjes së të ardhurave dhe pagesave të detyrimeve që shteti mbledh apo ka ndaj të tretëve, realizoheshin nëpërmjet instrumentit çek/urdhër pagese, duke mbyllur ciklin e shlyerjes së tyre manualisht në sistemin e pagesave AIPS. Në fillim të vitit 2010, Ministria e Financave është bërë pjesë e sistemeve kombëtare të pagesave, si një pjesëmarrëse me të drejta të kufizuara. Projekti i realizimit të kësaj pjesëmarrjeje ka zgjatuar tre vjet dhe është finalizuar faza e parë, me kryerjen e pagesave të detyrimeve të shtetit përmes sistemeve të konsoliduara tashmë në vend. Ministria e Financave është bërë përdorues i tërthortë i sistemit SWIFT. Kështu ajo mund të përdorë sistemin AIPS për pagesa me vlerë të madhe/ose urgjente, dhe sistemin AECH për pagesat jo-urgjente me vlerë të ulët. Përdorimi me efikasitet i këtyre sistemeve në kryerjen e pagesave, krijon midis bankave dhe Ministrisë së Financave të drejta dhe detyrime, të cilat duhet të zbatohen dhe të jenë në funksion të ekonomisë dhe konsumatorit Kjo përfshin rregullat e organizimit dhe funksionimit të procesit të komunikimit të sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave AMoFT dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH në Bankën e Shqipërisë.

Siç është treguar në diagramin më lart, Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, i cili administron fondet e buxhetit të shtetit, është pjesëmarrës me të gjitha degët e saj në vend. Degët janë të lidhura në kohë reale dhe punojnë në përputhje me sistemin qendror në Ministrinë e Financave, duke dërguar automatikisht informacionin në lidhje me të dhënat e pagesës. Këto udhëzime dërgohen në sistemin qendror të pagesave në Bankën e Shqipërisë, ku, në bazë të shumës së tyre dhe



Burimi: Ministria e Financave – sistemi thesarit



Një pjesëmarrje më e gjerë, qoftë dhe e kompanive të shërbimeve, mund të jetë e vlefshme dhe do të zgjerojë fushën e standartizimit të faturave të shërbimeve, duke bërë të mundur unifikimin e procesimit të tyre në sistemin bankar. Kjo do të ulte akoma më shumë kostot operacionale të sistemeve të pagesave, do të forconte besimin dhe bashkëpunimin e bizneseve me bankat dhe do të krijonte një sistem modern të menaxhimit të financave.



rëndësisë sistemike përpunohen prej këtij sistemi. Sipas instruksioneve të tyre, pagesa përfundon në bankat e nivelit të dytë, ku klientët përfitues mbajnë llogaritë e tyre bankare. Në këtë fazë të parë, nëpërmjet sistemeve të pagesave, Ministria e Financave realizon kryerjen e veprimeve për llogari të shpenzimeve të buxhetit të shtetit, ku përfshihen pagesat ndaj palëve të treta, rrogat buxhetore, ndihma dhe detyrimet tjera.

### Më pak para cash, më pak shpenzime

Faza e dytë e këtij projekti ka të bëjë me përfshirjen dhe përpunimin e pagesave të të ardhurave në favor të buxhetit të shtetit, nëpërmjet këtyre sistemeve. Ky është një projekt për të cilin po punohet dhe implemetimi i tij me sukses do të plotësojë ciklin e automatizimit të pagesave për dhe nga Buxheti i Shtetit. Ekzekutimi i tyre me anë të Sistemit Kombëtar të Pagesave realizon një monitorim të plotë dhe uljen e lëvizjes së pakontrolluar të parave cash. Gjithashtu, ai redukton shpenzimet për këto veprime operacionale, si nga ana e Qeverisë ashtu dhe për pjesëmarrësit e tjerë. I lidhur ngushtësisht me këtë fazë të dytë është dhe ndërtimi i infrastrukturës bashkëkohore i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për administrimin e taksave. Mbledhja e tatimeve dhe taksave nga subjektet që kryejnë veprimtarinë e tyre në

vend është shumë e rëndësishme për buxhetin e shtetit. Prandaj ky institucion, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe bankat në Shqipëri, realizon ekzekutimin e këtyre detyrimeve. Përdorimi i alternativave elektronike të hedhura në treg nga sistemi bankar, sjell një risi në këtë shërbim. Nëpërmjet shërbimit e-banking do të mund të realizohet kryerja e pagesave dhe deklarimi on-line i detyrimeve të bizneseve. Ky proces kërkon një pjesëmarrje të të gjithë faktorëve që veprojnë dhe përfitojnë nga këto shërbime. Standartizimi dhe unifikimi i dokumenteve të detyrimeve (formularët e tatimeve, të sigurimeve shoqërore & shëndetësore, fatura për arkëtim) të certifikuara dhe të pajisura me "bar code", do të jetë një investim i dobishëm për ndërtimin e një infrastrukture bashkëkohore, të frytshme dhe afatgjatë. Bankat e nivelit të dytë, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë në përzgjedhjen dhe implementimin me sukses të kësaj infrastrukture, duke konsideruar kostot e saj. Përvojat dhe shembujt e vendeve në rajon, por jo vetëm, mund të jenë një udhëzues domethënës për ne. Ndërkohë, një pjesëmarrje më e gjerë, qoftë dhe e kompanive të shërbimeve, mund të jetë e vlefshme dhe do të zgjerojë fushën e standartizimit të faturave të shërbimeve, duke bërë të mundur unifikimin e procesimit të tyre në sistemin bankar. Kjo do të ulte akoma më shumë kostot operacionale të sistemeve të pagesave, do të forconte besimin dhe bashkëpunimin e bizneseve me bankat dhe do të krijonte një sistem modern të menaxhimit të financave. Gjithashtu mbështetja legislative nga Qeveria Shqiptare luan një rol të rëndësishëm në këtë projekt.

## Në numrin e ardhshëm do të lexoni:

### Siguria Fizike në Banka

Nga: Z. Bajram Ibraj; Z. Qirjako Taçe dhe Z. Sokrat Dylgjeri



“Qëndroni me Ne  
për të marrë  
më të mirë në Treg”



Banka Nderkombetare Tregtare  
International Commercial Bank

## Ofertën

“Rrituni  
së bashku  
me NE”

### Toptani Branch and Head Office

Rruga "Murat Toptani"  
(Eurocol Center)  
Tirane Albania  
Tel: 4 2256 254 / 2254 372 / 2235 406  
Fax: 4 2235 409 / 2254 368  
Email: toptani@icbank-albania.com

### Kombinat Branch

Rr.'Fabrika e Qelqit', Pallati 56  
Shk.3, Ap.17,  
Tirane Albania  
Tel: 4 2351 903  
Fax: 4 2352 236  
Email: kombinati@icbank-albania.com

### New Tirana Branch

Rr.'Komuna e Parisit'Kati perdhes ne pallatin  
E kompleksit KIKA (Near New York Univer-  
sity)  
Tirane Albania  
Tel: 4 2320 972  
Fax: 4 2320 970  
Email: tiranare@icbank-albania.com

### Porcelan Branch

Rr.'Qemal Stafa'  
Pallati 543/1,  
Tirane Albania  
Tel: 4 2347 144  
Fax: 4 2346 619  
Email: porcelani@icbank-albania.com

### Ded Gjo Luli Branch

Rr."Ded Gjo Luli", Nr.3,  
Tirane Albania  
Tel: 4 2237 568 / 569  
Fax: 4 2237 570  
Email: dedegjoluli@icbank-albania.com

### Fier Branch


Lagjia "Kongresi i Permetit",  
Rr. Jakov Xoxa, Nr.11,  
Fier Albania  
Tel: 34 231809  
Fax: 34 231808  
Email: fier@icbank-albania.com

### Lushnje Branch

Shetitorja kryesore prane Muzeut,  
Lagja "Kongresi i Lushnjes"  
Lushnje Albania  
Email: lushnje@icbank-albania.com

### Durrës Branch

L.9, Rruga "A.Goga",  
P.71/1, prane Gjykates  
Durrës Albania  
Email: durres@icbank-albania.com



## BANKAT SHQIPTARE kujdesi për të mbajtur të pacënuar sistemin

Teksa ekonomia bëhet më e formalizuar më shumë paga kalojnë përmes bankave, bilancet e bizneseve bëhen më të besueshme dhe shanset për kredi rriten. Megjithatë sërish disa ekspertë preferojnë të jenë të matur

*Nga Klodi Tomorri*

Në mars të vitit 1997, kur ligji kishte kapitulluar dhe Shqipëria u zhyt në anarkinë e rrugës, një bandë gangsterësh të armatosur në Gjirokastrë sulmuan me tank degën lokale të ish-Bankës së Kursimeve, sot Raiffeisen Bank. Ngjarja që u pasqyrua edhe nga mediati e huaja, la pa gojë shumëkënd. Ndryshe nga grabitjet spektakolare në skenat klasike të filmave apo vjedhjet ordinere në sportele botë nuk kishte parë ndonjëherë se bankat mund të vidheshin edhe me tank. Për shumicën e shqiptarëve të rritur, kujtimet e ankthit të pamasë të atij vitit të mbrapshtë mbeten ende të gjalla edhe sot. Kolapsi i skemave piramidale, ku shqiptarët humbën rreth 1.2 miliardë dollarë kursime, u pasua nga një anarki, në kufijtë e luftës civile me grabitje dhe vrasje, ku shteti nuk ekzistonte dhe ligjin e bënin bandat e rrugëve. Më shumë se 12 vjet pas kësaj ngjarje askush nuk mund ta imagjinonte se sistemi bankar shqiptar do të ishte ndër të paktët në Evropë që do të përballonte me sukses krizën globale të financave, që nuk kurseu as gjigantët e sistemit bankar botëror. Dhe kjo për disa arsye. Së pari integrimi i kufizuar i vendin në ekonominë botërore dhe sistemin global të financave e ruajti atë nga ekspozimi tek të ashtuquajtura asetet toksike dhe bankat e këqija. Tregu i letrave me vlerë të korporatave ende nuk ekzistonte atëherë dhe nuk ekziston as tani, ndërsa nuk kishte një bursë që të kolapsonte.



### Kujdesi paguan

Megjithatë do të ishte naive të mendohej se sistemi bankar shqiptar i shpëtoi krizës vetëm se ishte i pazhvilluar. Fondi Monetar thotë se Shqipëria ka sot një sistem bankar solid edhe për shkak të politikave të kujdesshme që janë ndjekur në të kaluarën. "Në vitin 2007-2008 kur ne hartuam një sërë rregulloresh, të cilat fuqizonim mbikëqyrjen dhe kishin në themel kujdesin, shpesh na akuzonin edhe për konservator. Por sot po marrim mbrapsht kthimin e kësaj politike kujdesi," thotë Indrit Banka, kreu i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Në fund

të gjashtëmujorit të parë të vitit depozitat totale në sistemin bankar ishin 825.4 miliardë lekë me një rritje prej 15.2 për qind krahasuar me një vit më parë. 16 bankat e sistemit mbështeten në një bazë të fortë depozitash, tregues që gjithmonë ka qëndruar mbi 80 për qind të asetëve të sektorit. Raporti i kredive me depozitat ishte në fund të qershorit 62.5 për qind, dukshëm më ulët nga mesatarja e Evropës Qendrore ku ky tregues qëndron në mbi 106 për qind. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në fund të vitit të kaluar, 16.2 për qind dukshëm lart kufirit 12 për qind. Përgjatë kësaj kohe Banka e Shqipërisë ka qenë e kujdesshme

ta mbikëqyrë imtësisht sistemin dhe të fuqizojë masat rregullatore. Në dhjetor të vitit 2009, Këshilli Mbikëqyrës miratoi një rregullore të re "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", e cila në thelb kishte ndryshimin e përkufizimit të atyre që do konsiderohen si aktive likuide, duke i bërë ato më konservatore. Rregullorja e re e likuiditetit solli dhe hyrjen në fuqi të kufirit rregullator për treguesin e aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra deri në një vit, tregues i cili raportohet çdo muaj me bazë javore dhe në total monedhash nuk duhet të bjerë nën nivelin prej 20%. Në dhjetor 2010 ky tregues shënon 30.6%, nga ku 42.9% në lekë, 15.6% në euro dhe 23.9% në dollarë amerikanë. Teksa sistemi financiar në botë kishte filluar të ndjente sinjalet e para të asaj që më vonë do të konsiderohej si një nga krizat më të egra që nga lufta e dytë botërore, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me bankat private projektonte masa të reja rregullatore për të mbajtur të pacenuar sistemin.

### Rikthimi në stabilitet

Me gjithë këto masa kujdesi, kolapsi i Lehman Brothers në shtator të vitit 2008 përcolli panik në treg. Klientët nxituan të shkonin në sportelet e bankave duke tërhequr deri në 15 për qind të depozitave. Por për shkak se sistemi ishte likuid nuk pati asnjë shenjë se bankat ishin në rrezik. Në muajt e parë të vitit 2009 depozitat filluan të rihynin në sistem. Në vitin më të vështirë 2009, ekonomia shqiptare u rrit me 3.3 për qind dhe përshpejtoi në 3.9 për qind në 2010-ën. Në mënyrë të ngjashme asetet e sektorit bankar u rritën me 6.3 për qind në 2009-ën dhe 11.8 për qind në vitin 2010 duke arritur në mbi 990 miliardë lekë ose 81 për qind e Prodhimit Kombëtar. Fitim neto ishte vitin e kaluar 6.7 miliardë lekë ose 89 për qind më shumë se sa në 2009-ën. Treguesi i RoAA përllogaritet në nivelin 0.72 për qind dhe shumë më i lartë sesa ai i fundit të vitit 2009, prej 0.42 për qind, ndërsa kthimi për aksion (ROE) ishte 7.58 për qind, nga 4.58 për qind në 2009-ën. Sërish ky tregues mbetet më poshtë nivelit 10.3 për qind që shënoi në 2008-ën për shkak të efektit të kredive të këqija.

### Rigjallërimi i kredisë

Në 6 muajt e parë të vitit, kredia për sektorin privat u rrit sipas bankës së Shqipërisë me 11.5%, një ritëm ky rreth 1.5 pikë përqindje më i lartë se ai i gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar. Në ndryshim nga vitet e shkuara, aktiviteti kreditues shfaq një orientim më të madh drejt përdorimit të monedhës kombëtare. Kredia në lekë është rritur me rreth 14% deri në muajin maj. Ecuria e kreditimit vazhdon të ndikohet nga kërkesa e moderuar për kredi, ndërkohë që edhe sistemi bankar ka adoptuar praktika të kujdesshme kredidhënieje, duke mbajtur kushte të shtrenguara kreditimi për segmente të veçanta të tregut. Financimi i konsumit privat, për shembull, nëpërmjet kredisë konsumatore mbetet i ulët. Teprica



e kredisë konsumatore ka shënuar një rritje vjetore të papërfillshme, me vetëm me 0.4% gjatë tremujorit të parë të vitit 2011. Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank thotë se kredia për individët në një masë të madhe pengohet edhe nga infrastruktura si mungesa e një sistemi formal adresash. Megjithatë ekspertët presin që rigjallërimi i kredisë të vazhdojë në pjesën e mbetur të vitit më shumë në kahun e biznesit se sa atë të individëve. Ecuria e mirë e depozitave ka ndihmuar bankat të kenë likuiditet të bollshëm dhe ka krijuar më shumë hapësirë për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin kreditues. Megjithatë, edhe në kredinë për biznesin ka pengesa. Shumë bankierë nënvizojnë qeverisjen e dobët të korporatave dhe

bilancet shpesh të pabesueshme, të cilat pengojnë kreditimin. "Ka ende shumë informalitet në ekonominë shqiptare," shprehet njëri prej tyre.

### Kredi më e mirë

Për shumë ekspertë një nga sfidat kryesore të sistemit bankar në përgjithësi do të jetë kreditimi i klientëve të mirë. Ata mendojnë se mësimet e krizës nuk do të harrohen lehtë dhe do të shërbejnë që ti mbajnë bankat të kujdesshme mbi rëndësinë e kriterëve të kreditimit. Në fakt disa shenja përmirësimi shihen që tani. Në shkurt të vitit të kaluar qeveria inauguroi regjistrin kombëtar të adresave, ndërsa prej disa muajsh në vend kanë filluar të funksionojnë edhe përbaruesit privat. Sistemi i ngadalhtë i ekzekutimit është një plagë e hershme për bankat. Me hyrjen e përbarimit privat gjasat janë që situata të përmirësohet. Me shërbimin privat të përbarimit, qeveria e ka bërë pjesën e saj.

Tani i takon gjykatave të thonë fjalën e tyre. Petrit Qarri, i Dhomës Kombëtare të Përbaruesve thotë se përgjithësisht për kredi në shuma të mëdha, gjykatat tentojnë të jenë të ngurta dhe të zvarrisin proceset. Sipas tij, kjo duhet të marrë fund pasi një sistem i shpejtë ekzekutimi është në të mirën e të gjithëve. "Ai do të jetë i mirë për shtetin, është i mirë për bankat dhe madje edhe për vetë klientët," thotë Qarri. Për më tepër disa ligjet të tjera po e lëvizin ekonominë drejt formalizimit. Transaksionet më të mëdha se 300 mijë lekë tani janë të detyrueshme që të kalojnë përmes bankave, ndërsa më në fund të gjithë bizneset tashmë janë pajisur me kasa dhe i takon administratës tani të mbikëqyrë përdorimin e tyre. Teksa ekonomia bëhet më e formalizuar më shumë paga kalojnë përmes bankave, bilancet e bizneseve bëhen më të besueshme dhe shanset për kredi rriten. Megjithatë, sërish disa ekspertë preferojnë të jenë të matur.



# PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE, pjesë e administrimit dhe kulturës së bankave

### TIRANA BANK Nisma e Kryqit të Kuq Shqiptar “Dhuro gjak”



Tirana Bank ka qenë nismëtarja e veprimtarisë së dhurimit të gjakut nga bankat shqiptare. Edhe këtë vit punonjësit kanë marrë pjesë gjerësisht në këtë akt humanitar të organizuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, duke e renditur këtë institucionin të parin në rang vendi për kontributin në dhurimin e gjakut.

### “Një qytetar një pemë” nisma e Bashkisë së Tiranës



Tirana Bank ka mbështetur për 3 vite radhazi projektin “Një qytetar, një pemë” të nisur nga Bashkia e Tiranës.

Që nga viti 2009, Tirana Bank ka kontribuar për shtimin e hapësirave të gjelbra përgjatë rrugës së “Elbasanit”, rrugës së “Durrësit” dhe parkut “Rinia”.

### ALPHA BANK Rritja e përgjegjshmërisë sociale, kujdes për artizanët




Përgjatë vitit 2010, Alpha Bank-Albania, Sponsorizoi Panairin e Mjeshtreve Duarartë të qytetit të Pogradecit.

Vizitoi Shtëpinë e të Moshuarve të Tiranës, një vizitë e cila solli buzëqeshje dhe momente të gëzueshme për të moshuarit, një komunitet në nevojë për përkujdesje dhe dashuri. Punonjësit e Alpha Bank shpërndanë dhurata të ndryshme duke i'u përshtatur nevojave më emergjente të azilit, si dhe kaluan disa orë duke bashkëbiseduar me banorët e tij.

### FIBANK Interes për punësimin e studentëve



Fibank sponsorizoi edhe këtë vit projektin e organizuar nga Bashkia e qytetit të Korçës, mbi Punësimin Sezonal të Studentëve. Dega e Korçës në bashkëpunim me punonjësit e bashkisë organizuan ceremoninë e mbylljes së këtij aktiviteti në ambjentet e degës sonë. Gjatë kësaj ceremonie, në të cilën morën pjesë Kryetari i Bashkisë, punonjës të bashkisë, Drejtori Ekzekutiv i Fibank, punonjës të Fibank dhe rreth 60 studentë të përfshirë në këtë projekt, iu shpërndanë certifikata të lëshuara nga të dy këto institucione. Ky projekt cilësohet si i suksesshëm për bankën tonë pasi krijon një lidhje më të qëndrueshme me bashkinë e qytetit.



ANALIZË

## Fqinji jugor dhe BANKAT ETIJ në Shqipëri



Nga Kasem Seferi  
Ekonomist

Në çfarë mënyre do të ndihmohen vendet e Ballkanit, veçanërisht, ato që janë shtrënguar nga borxhi i jashtëm, në përballimin e krizës?

**K**apitali grek ka kontribuar shumë për transformimin e fqinjëve të tij gjeografikë, pasi kohët e fundit vlerësohet se rreth 8 000 ndërmarrje greke kanë investime në vendet ballkanike, ndërkohë që rreth 20 për qind e qarkullimit vjetor të shumë prej tyre realizohet në këto vende.

Rrugët e këtij “invadimi” të kapitalit grek janë të ndryshme, por ajo që paraqit më shumë interes është ajo e sistemit bankar grek, i cili është një sektor modern dhe me përfitim në ekonominë e Greqisë, vendimtar për zhvillimin e krizës në Greqi dhe në vendet e tjera ballkanike, sidomos në Shqipëri, ku bankat greke mbajnë përqindje të rëndësishme të tregut, kanë shumë degë dhe punësojnë mjaft njerëz. Arsyet kryesore përse bankat greke investuan fort në Shqipëri janë: përqindjet e larta të rritjes ekonomike dhe ekzistenca e një sistemi bankar të pazhvilluar dhe joeficient vendas, i cili po përjetonte një program shumë të madh privatizimi; këta faktorë ofruan mundësi përfitimi për shkak të kërkesës së rritur, si nga familjarët, ashtu dhe nga ndërmarrjet e ndryshme, kryesisht të huaja, të prodhimit të fabrikuar dhe të shërbimeve, prej të cilave një numër i konsiderueshëm ishin të kapitalit grek. Për të paktën 5 - 10 vjet, përqindja vjetore e rritjes së PBB - së në Shqipëri ka qenë më e lartë se sa mesatarja në 27 vendet e BE - së: 6 për qind kundrejt 1 - 3 për qind.

E ashtuquajtura “pjekuri” e tregut bankar grek, e cila kishte filluar t’i frenonte shtresat e fitimit, nevoja

për të përballuar konkurrencën nga vendet e tjera europiane, kryesisht Austria, Franca, Italia dhe Gjermania, të cilat gjithashtu mezi prisnin të merrnin përqindje të mëdha të sektorit bankar në Shqipëri për të njëjta arsye si dhe bankat greke, kosto e ulët e punës në Shqipëri (të cilat janë dy ose shumë herë më pak se sa ato në Greqi ose 30 deri 70 për qind, respektivisht, të atyre të Europës Qendrore dhe Lindore), planet e përgjithshme gjeostrategjike të Shtetit Grek për vendet e Ballkanit, BE - së dhe përgjithësisht Perëndimit, janë po ashtu arsye të investimit bankar grek në Shqipëri.

### Bankat greke dhe Shteti

Në përpjekjet e tyre për t’u zgjeruar në këto vende, bankat greke u ndihmuan nga Shteti Grek, si pjesë e të ashtuquajturës “diplomaci ekonomike”, e cila i shërbeu “interesave kombëtare” (imperializmit grek), si dhe prania e përgjithshme ekonomike dhe ushtarake e imperializmit perëndimor në zonën e Ballkanit. I rëndësishëm në këtë kuadër është Plani Helenik për Rindërtimin Ekonomik të Vendeve Ballkanike (HiPERB), i ndërmarrë nga Greqia si anëtare e BE - së, e cila ishte veçanërisht e interesuar për Shqipërinë, Bosnje - Hercegovinën, Bullgarinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë), pasi “Qëllimi i planit, mbi të gjitha, ishte dhe mbetet stabiliteti politik, ekonomik dhe shoqëror në Europën Juglindore, ndërkohë që qëllimi më i fundit

është modernizimi i infrastrukturës, promovimi i investimeve prodhuese dhe mbështetja institucioneve demokratike dhe shtetit ligjor.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm i HiPERB - it është të mbështesë Shqipërinë drejt perspektivës europiane për arsye të afërsisë gjeografike, lidhjeve kulturore dhe historike, si dhe ekzistencës së pakicës greke si një nga arsyet shumë të rëndësishme për praninë e rritur të bankave greke në Shqipëri, pa harruar tatimet e ulta dhe nxitësit e tjerë të ofruar nga Shqipëria.

Gjatë dhjetë viteve të fundit bankat greke penetruan thellë në sistemin bankar shqiptar (sipas të dhënave të përpunuara të EBRD - së, deri në vitin 2007, Emporiki Bank Albania SA [degë e EMPORIKI BANK]: 18 degë dhe 158 të punësuar; Albania Tirana Bank [degë e PIRAEUS BANK]: 39 degë dhe 448 të punësuar), me një qëllim strategjik të rritjes graduale të shërbimeve bankare me pakicë (kryesisht hua konsumatore dhe për shtëpi, si dhe karta krediti). Në vitin 2005, pjesëmarrja e kapitalit bankar



grek në dhënien e huave ishte 35.7 për qind në Shqipëri, por nuk kanë qenë vetëm bankat greke ato që kanë investuar në Shqipëri, gjë që tregohet nga fakti se në vitin 2007 bankat e huaja zotëronin 94.2 për qind të sektorit bankar.

### Shqipëria dhe ekonomia e saj

Situata në Shqipëri para krizës ekonomike, nga këndvështrimi i bankave greke, mund të përshkruhet si vijon: përqindje të larta të rritjes ekonomike (sipas të dhënave të përpunuara të EBRD – së, 1997: – 10.9%; 1998: 8.6% ; 1999: 13.2 %; 2000: 6.5 %; 2001: 7.1%; 2002: 4.2%; 2003: 5.8 %; 2004: 5.7%; 2005: 5.7%; 2006: 5.5%; 2007: 6.2%, 2008: 6.9 për qind dhe 2009: 3.3%), privatizim i shpejtë, penetrim i kapitalit të huaj në sektorët jetësor të ekonomisë së vendit (përfshi sektorin bankar) rritje ekonomike e udhëhequr nga kërkesa, bazuar në konsumin kombëtar (financuar në pjesën më të madhe nga huatë e bankave të huaja në valutë) dhe kërkesa e jashtme (eksportet plus remitancat).

Shembulli i Greqisë në këtë rast është karakteristik, sepse kur qeveria greke ofroi një paketë prej 128 miliard për bankat vendase, guvernatori i Bankës Qendrore të Greqisë u ngut t'i "këshillonte" ato të ishin "të matura" në zgjerimin e fondeve për filialet në vendet e Ballkanit (Shqipërinë) ... Pasojat e shkurtimit të një kreditimi të tillë, në qoftë se me të vërtetë u



nënkuptua dhe u zbatua, mund të ketë qenë shumë i dëmshëm për Shqipërinë, pasi sikundër po ndodh në vitet 2010 – 2011 u përshpejtua rënia e konsumit dhe e investimit.

Përveç kësaj, investimi i huaj i cili përdoret për të qenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave në Shqipëri pritet të bjerë, kryesisht për shkak të problemeve ekonomike të vendeve të zhvilluara kapitaliste; remitancat e emigrantëve që punojnë jashtë Shqipërisë që janë një faktor i rëndësishëm për shëndetin e ekonomisë shqiptare (FMN – ja për sa i përket rritit të Greqisë i ka vlerësuar mesatarisht në 778 milion US\$/vit për dekadën e fundit dhe numrin e emigrantëve në 500 mijë), priten të influencohen negativisht nga kriza, sepse këta punonjës janë goditur ashpër nga rënia ekonomike në industrinë e prodhimit të makinave, ndërtimit dhe shërbimeve shtëpiake. Pushimet nga puna dhe mungesa e kërkesës për punë, si rezultat i krizës, do t'i detyronte këto emigrantë të ktheheshin në Shqipëri, gjë që shtoi presionin në tregjet e punës dhe rriti papunësinë.

### Ekonomia në raport me stabilitetin e monedhës

Një barrë shtesë për ekonominë shqiptare mbetet presioni mbi monedhën kombëtare lekë në raport me euron dhe US\$, duke e futur atë në dilemën: ta zhvlerësojnë apo ta mbajnë stabilë monedhën lekë. Stabiliteti i monedhës lekë rrezikon ta çojë ekonominë më thellë në rënie, ndërsa zhvlerësimi i saj rrezikon të rrisë dështimin që nga ajo kohë që familjarët dhe bizneset nuk do të jenë në gjendje t'i paguajnë huatë e marra prej tyre, ndërkohë që eksporti ra pasi ra kërkesa importuese e Greqisë.

Efektet e krizës në Shqipëri janë

çdo gjë, por mbi të gjitha dukuri vendore, sepse avantazhi krahasues i pranisë së rritur të bankave greke në këtë zonë, mund të kthehet në dizavantazh krahasues për arsytet e mëposhtme: rrënuja potenciale ekonomike ka të ngjarë të ketë efekte përhapëse të kundërta në tregjet vendase të bankave greke mëmë sepse risku i dështimit në huatë që filialet e tyre ishin duke ofruar gjërisht gjatë periudhës së fundit nuk është domethënës, veçanërisht, në rastet kur ka një zhvlerësim të monedhës vendase lekë që rrit detyrimet e familjarëve kundrejt huave që ata kanë marrë në filialet e bankave greke. Sipas qeverisë greke dhe Bankës Qendrore të Greqisë bankat greke janë të sigurta, përveç faktit që janë përhapur shumë në vendet ballkanike. Sikundër u përmend më lart, nxitja e guvernatorit të Bankës Qendrore Greke për të "huazuar brenda vendit" jo vetëm që do të ndikonte në mënyrë të kundërt të familjarët dhe bizneset, por dhe te bizneset greke në Shqipëri. Për më shumë bankat greke po riskojnë të humbasin pjesën e tregut në Shqipëri, sepse depozitat do të lëvizin drejtimit të bankave të tjera. Në këto rrethana, pyetjeve të cilat duhet t'i përgjigjen vendet e Europës Perëndimore dhe institucionet ndërkombëtare janë: A duhet të luajë BE – ja ndonjë rol në mbështetjen e ekonomive të Ballkanit, qofshin ato anëtare të reja të BE – së, ose kandidatë potenciale për anëtarësim në BE, në kuadër të "solidarititetit" që nuk është vënë re madje te anëtarët e vjetër?

Në rrethanat e tanishme Shqipëria duket se është në një pozicion më të mirë për shkak të lidhjeve relativisht të pakta që ka me ekonominë ndërkombëtare, sepse sipas Bankës së Shqipërisë, sektori i saj bankar është i mirëkapitalizuar dhe likuid.





## BESOJANI DEPOZITAT TUAJA INTESA SANPAOLO BANK

NJË BESIM I MBËSHTETUR NË 400 VJET HISTORI BANKARE.



**INTESA SANPAOLO BANK**

*Drejt të ardhmes me ju.*





AKTIVITET

## VEPRIMTARITË e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Janar - Shtator 2011

### ÇËSHITJE OPERACIONALE

#### Mbi tarifaf dhe komisionet e bankave

Për të siguruar më shumë informacion në funksion të debatit publik mbi tarifaf dhe komisionet e shërbimeve bankare, Sekretariati i AAB-së përgatiti një raport/analizë për të krahasuar tarifaf dhe komisionet e bankave në Shqipëri me ato të aplikuara nga 15 banka në 9 vende të ndryshme në rajon, e cila iu bë e njohur publikut përmes një deklarate për shtyp, dhe u publikua në faqen e internetit të AAB-së.

#### Propozimi për ndryshime në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat

Si anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit (KKB), AAB u njoh në prill 2011 me një projekt-propozim për ndryshime në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", me synim mosnjohjen si shpenzime të zbritshme të shpërblimeve për punonjësit, dhe ndryshimin e tatimit mbi të ardhurat e biznesit, nga e sheshtë (10%) në progresive, bazuar në marzhet e fitimeve të kompanive. AAB, në emër të bankave anëtare, adresoi kundërshtimet ndaj ndryshimeve të propozuara për KKB dhe Ministrinë e Financave, bazuar në shumë argumente politike, ekonomike dhe teknike, si: rëndësia e bonuseve në menaxhimin e aktivitetit bankar, efektet negative që taksa progresive do të ketë mbi ekonominë në përgjithësi, llojin e paprecedent të normës së propozuar, ndikimin negativ edhe në bizneset e vogla, dhe efektet negative në investimet e huaja direkte, aq shumë të nevojshme për Shqipërinë.

#### Ligji për amnistinë fiskale dhe legalizimin e kapitalit



Në kuadrin e Ligjit të ri për Amnistinë Fiskale, për të lehtësuar zbatimin e Udhëzuesit të Ministrisë së Financave për legalizimin e të hollave dhe pasurisë në banka, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim në qershor të 2011-ës me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Bankës së Shqipërisë. Mbështetur mbi diskutimet në këtë takim AAB kërkoi disa ndryshime në Udhëzim të cilat u realizuan, dhe u ndoqën nga një seminar i organizuar nga AAB me qëllim informimin e plotë të personelit të bankave mbi procedurat operationale për zbatimin e procesit dhe informimin e klientëve. Në vijim, AAB sponsorizoi një spot televiziv informativ mbi lehtësirat e ofruara nga bankat në këtë proces, i cili u transmetua në pesë kanale televizive gjatë muajit korrik 2011.

### AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

#### Komiteti i Fraud-it (Mashttrimit) të Kartave (KFK)

KFK pati dy takime gjatë gjysmës së parë të vitit, ku u diskutua mbi zhvillimet e fundit në mashttrimet me kartat në Shqipëri, si edhe u përgatit Forumi Kombëtar Shqiptar Kundër Mashttrimit. Dy takime të tjera të KFK-së pasuan në korrik 2011, (e fundit së bashku me Komitetin e Sigurisë Bankare), ku temë kryesore ishin zhvillimet e fundit e ngjarjet e mashttrimit me kartat, si dhe veprimet e përbashkëta për t'u ndërmarrë nga bankat dhe forcat e policisë për zbulimin dhe kapjen e mashtruesve.

#### Komiteti i Përputhshmërisë (KP)

Komunikimi mes të KP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) vazhdoi gjatë gjithë nëntëmujorit janar - shtator 2011, ku u organizuan pesë takime me përfaqësues të të dyja palëve si edhe Bankës së Shqipërisë, me qëllim kryesor përmirësimin e raportimit të bankave për Drejtorinë për një luftë intensive për parandalimin e pastrimit të parave.

### Komiteti Ligjor (KL)

KL u mbledh në janar 2011, në një takim me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, për të diskutuar në lidhje me procedurat e ekzekutimit të urdhrave të bllokimit të Bashkisë. Në qershor, përfaqësuesit e KL patën një takim me Kryeregjistruesin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), për të diskutuar shqetësimet e bankave lidhur me pasuritë e paluajtshme që shërbejnë si kolateral i kredive bankare. Takimi ishte konstruktive dhe në të u gjetën zgjidhje administrative të disa prej çështjeve.

### Komiteti i Sistemeve të pagesave (KSP)

KSP pati takimin e parë të vitit në shkurt 2011, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ministria e Financave, dhe Bankës së Shqipërisë. Pjesëmarrësit diskutuan mbi çështje me interes të përbashkët në lidhje me pagesat për dhe nga buxheti i shtetit. Në takimin e Komitetit në qershor morën pjesë përfaqësues të Bankës së Italisë në kuadër të projektit të binjakëzimit të tyre me Bankën e Shqipërisë, të cilët prezantuan mundësinë e realizimit të një skeme kombëtare për kartat e debitit.

### Komiteti i Sigurisë Bankare (KSB)

KSB pati pesë takime gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Në takimin e parë në janar, Komiteti zgjodhi kryesinë e re ku z. Bajram Ibraj dhe Z. Sokrat Dylgjeri u rikonfirmuan si kryetar dhe Zëvendës Kryetar respektivisht, dhe Zëvendës Kryetari i dytë u zgjodh Z. Roland Tashi, nga ProCredit Bank.

Në takimet e tjera të Komitetit, anëtarët e tij ndanë informacion mbi evente dhe eksperiencat me çështje të sigurisë dhe diskutuan mbi tema relevante si: strategjitë dhe praktikën më të mira në parandalimin e grabitjeve të bankave; menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit; detyrimet dhe procedurat për sigurinë në punë; si dhe çështje të tjera më praktike.

### Komiteti i Sigurisë së Informacionit (KSI)

I sapo themeluar, Komiteti i AAB-së për Sigurinë e Informacionit, pati mbledhjen e parë në janar 2011, në të cilin anëtarët zgjodhën Kryetare - Zj. Anila Hoxha nga Raiffeisen Bank, dhe dy Zv. Kryetarët - Z. Akil Ndrenika nga Banka Kombëtare Tregtare dhe Z. Valsi Thomollari nga Alpha Bank. KSI pati edhe dy takime në prill dhe qershor, ku anëtarët diskutuan mbi programin dhe objektivat e punës së ardhshme të Komitetit; standardet ISO, llojet e sulmeve të tilla si phishing dhe malware; Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Shqipëri dhe zbatueshmërinë e tij në banka; siguria Online për eBanking dhe Mobile banking; rëndësinë dhe mjetet për ndërgjegjësimin e konsumatorëve; nënshkrimet dixhitale; etj..

## EVENTE

### Forumi Kombëtar Shqiptar Kundër Mashtrimeve



Forumi i parë Kombëtar Shqiptar Kundër Mashtrimeve, u organizua nga Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Komiteti i saj për Luftën Kundër Mashtrimit me Karta në Prill 2011, në Hotel Sheraton, Tiranë. Ai mbuloi zhvillimet kryesore të industrisë së kartave si nga këndvështrimi i mbrojtjes nga

mashttrimet por dhe ndjekjes e kapjes së tyre. Pjesëmarrës në Forum ishin përfaqësues të bankave tregtare, punonjës të forcave të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë Shqiptare, si dhe përfaqësues nga: OPDAT, Banka e Shqipërisë, kompanitë partnere të kartave Visa International dhe MasterCard, Intesa Sanpaolo Card, kompania Printec Albania, dhe përfaqësues nga Forumi Kosovar Kundër Mashtrimeve me Kartela.

Prezantimet në Forum përfshinë çështje si: analiza e vlerës së riskut të transaksioneve fraud për vitin 2010; praktikën më të mira me mjetet dhe teknikat e përdorura për monitorimin dhe parandalimin e mashtrimeve; ecuria e mashtrimeve dhe metodat më të mira për një monitorim

efektiv dhe zhvillimet e fundit nga MasterCard; strategjia e VISA Card në lidhje riformatimin e sigurisë së sistemeve të pagesave me kartë; zgjidhje teknologjike dhe mjetet për parandalimin e mashtrimit të ofruara aktualisht në Shqipëri; rastet konkrete të suksesshme të hetimit, ndjekjes penale dhe arrestimin e grupeve kriminale, etj..



## AAB dhe Statistika

### Trajnim i bankierëve shqiptarë organizuar nga TBA

Shoqata Turke e Bankave organizoi dhe financoi një trajnim një javor "Banka dhe Financa" për 10 bankierë shqiptarë, ku pjesëmarrësit patën mundësi të zgjerojnë njohuritë e tyre mbi tema të tilla si: produktet financiare; standardet IFRS; menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e degëve; si dhe u prezantuan me përvojën dhe eksperiencat në zhvillimin e sektorit bankar Turk pas krizës financiare, si edhe kuadrin rregullator të miratuar në këtë drejtim.

### Anëtarësimi në BACEE

















Sekretariati përfundoi anëtarësimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave në BACEE (Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore e Lindore) pasi konfirmoi që anëtarët e AAB-së do të gëzojnë të njëjtat përfitime si anëtarë të BACEE-s, në eventet që kjo e fundit organizon.

## TË DHËNA MBI SISTEMIN BANKAR - GUSHT 2010 / 2011

milionë LEK			
Nr	TREGUESI	Gusht 2010	Gusht 2011
1	<b>Totali i mjeteve</b>	<b>961,947.2</b>	<b>1,078,910.3</b>
2	<b>Toali i huave</b>	<b>471,871.4</b>	<b>531,676.3</b>
	2.1 Hua për individë	145,249.2	155,036.3
	2.2 Hua për biznes	326,622.2	376,640.0
3	<b>Totali i depozitave</b>	<b>775,765.6</b>	<b>888,187.1</b>
	3.1 Depozita nga individë	657,196.4	766,423.3
	3.2 Depozita nga biznese	118,569.2	121,763.9
4	<b>Fitimi (kumulativ)</b>	<b>4,876.0</b>	<b>2,049.9</b>
5	<b>Kapitali aksioner</b>	<b>90,689.4</b>	<b>93,611.6</b>
në %			
6	<b>Mjaftueshmëria e Kapitalit*</b>	16.85	14.64
7	<b>ROE - Kthimi nga Kapitali i vet</b>	8.4	3.3
8	<b>ROA - Kthimi nga Mjetet</b>	0.8	0.3
9	<b>Hua me Probleme/Totali i Huave</b>	13.5	18.0
10	<b>Nr. i degëve &amp; agjencie**</b>	533	548
11	<b>Karta me funksion cash-i</b>	644,557	712,575
12	<b>Karta me funksion pagese</b>	644,557	712,575
13	- Karta Debiti	617,183	682,109
14	- Karta Krediti	27,374	30,466
15	<b>Nr. i ATM-ve</b>	761	783
16	<b>Nr. i POS-eve</b>	4,680	4,729
17	<b>Nr. i transaksioneve me karta***</b>	6,645,468	7,483,644
18	<b>Volumi i transaksioneve me karta (në mil LEK)***</b>	66,964	75,985

\* Në Qershor 2010 / 2011  
 \*\* Në Dhjetor 2009 / 2010  
 \*\*\* Të dhëna kumulative për vitin përkatës

## ANETARËT E AAB

 <b>ALPHA BANK</b>
 <b>BKT</b> BANKA KOMBETARE TREGTARE
 <b>CREDINS bank</b>
 <b>CBA</b> CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPËSË
 <b>Emporiki Bank</b> CREDIT AGRICOLE GROUP
 <b>Fibank</b> First Investment Bank
 <b>Banka Ndërkombetare Tregtare International Commercial Bank</b>
 <b>INTESA SANPAOLO BANK</b> Albania
 <b>NBG Bank</b>
 <b>ProCredit Bank</b>
 <b>Raiffeisen BANK</b>
 <b>SOCIETE GENERALE ALBANIA</b>
 <b>TIRANA BANK</b>
 <b>UNION BANK</b>
 <b>UBA</b> United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë
 <b>VENETO BANKA</b> GRUPPO VENETO BANCA

